

Sejjid Hasan Nasrullah

SHKRETËTIRA E MAHSHERIT

Tiranë, 2016

Titulli: **Shkretëtira e Mahsherit**

Autori: **Sejjid Hasan Nasrullah**

Përktheu: **Vullnet Merja**

Recensent: **Sabrie Feza**

Redaktoi: **Esat Bunguri**

Përgatiti për shtyp: **Sabrie Feza**

Kopertina: **Sabrie Feza**

Botoi: **Shoqata "FLLADI"**

PARATHËNIE

Të gjithë e dimë mirë se një ditë do të largohemi nga kjo botë. Sado të jetojmë në këtë botë, sipas besimit tonë islam, si dhe të shumë feve të tjera, do të takohemi me Ditën e Llogarisë dhe me Jetën e Përhershme. Të gjithë e dimë se jeta jonë në këtë botë të shkatërruar nuk është gjë tjetër, vetëm se një provim për të merituar mirësinë e përhershme ose për të marrë ndëshkimin e përhershëm.

Dynjaja është një shtëpi kalimtare dhe një arë e Ahiretit, kurse vdekja është njoftim i përfundimit të veprës dhe i fillimit të llogaridhënies, është ura e kalimit nga kjo botë e shuar drejt Botës së Përjetësisë. Ajo është një nga realitetet më të mëdha e më të vërteta, më e rënda e më e idhëta. Prej asaj nuk mund të largohesh.

Përmendja e vazhdueshme e vdekjes, e llogaridhënies dhe e Ditës së Kijametit, rikthen ndërgjegjësimin e njeriut për jetën e tij, kurse rrëshqitja, mangësitë dhe neglizhenca e distancojnë atë nga ky ndërgjegjësim.

Shkëlqësia e tij, i nderuari Hasan Nasrullah (Zoti e ruajtë!), ka preferuar të flasë për vdekjen dhe shkretëtirën e Mahsherit, (vendgrumbullimin e njerëzve) dhe se çfarë do

ndodhë me njeriun gjatë netëve të Ashurasë të vitit 1437 h (2015)[1].

Duke parë rëndësinë e këtyre dy leksioneve, ne e pamë të rëndësishme analizimin e tyre në këtë libër duke ia prezantuar lexuesit dhe duke e lutur Allahun për veten tonë dhe për ju, për një fund të mirë dhe fitore të madhe.

1 Dy netët, e shtata dhe e nënta të muajit Muharrem të vitit 1437 h, 20 dhe 22 tetor 2015.

HYRJE

NË KUJTIM TË VDEKJES DHE BOTËS TJETËR

I Madhërishmi ka thënë në Librin e Tij Famëlartë: **"A jobesimtari e ka gjendjen më të mirë, apo ai që kohën e natës e kalon në adhurim, duke bërë sexhde, duke qëndruar në këmbë dhe i ruhet dënimit të Botës Tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të vet?" Thuaj: 'A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?Vërtet, vetëm të mençurit marrin mësim"**[2].

Në vazhdim do të trajtojmë bisedën për vdekjen dhe Ahiretin si dhe çështjet që lidhen me Ditën e Kijametit, Botën Tjetër etj. Do të ndalemi edhe në nevojat e diskutimit rreth detyrave dhe përgjegjësive tona si individë në këtë botë kundrejt Botës Tjetër, Ahiretit.

Pa dyshim, kjo çështje ka një rëndësi të madhe, sepse nga mënyra se si e vlerëson njeriu çështjen e vdekjes dhe të Ahiretit, konceptohen edhe shumë nga problemat e jetës dhe veprave të tij në këtë botë.

2 Suretu "Zumer", ajeti 9.

Si shembull për këtë do të shohim çështjen e Kerbelasë. Ngjarjet që ndodhën në Kerbela dhe rezultatet e tyre, shënojnë bazat mbi të cilat ngrihen çështjet e Dynjasë dhe të Ahiretit, këndvështrimi për Ahiretin dhe mënyra e marrëdhënies me të, njësoj si në ushtrinë e Imam Hysejnit (Paqja qoftë mbi të!), apo në ushtrinë e armiqve.

E VËRTETA E VDEKJES DHE PYETJET NGULMUESE

Para se të thellohemi në këtë studim do tregojmë se ka një të vërtetë të padiskutueshme, për të cilën të gjithë njerëzit bien dakord. Kjo çështje është "E vërteta e vdekjes." Që në kohën e Ademit (Paqja qoftë mbi të!), në ditët tona e deri sa të bëhet Kijameti, njerëzit do të kenë mendimin e padiskutueshëm se të gjithë janë të vdekshëm. Nëse do të kërkonim në gjithë botën, nuk do të gjenim asnjë njeri të arsyeshëm që të pretendojë apo pohojë përjetësinë e vetes së tij. Përkundrazi, çdokush është i bindur se do të vdesë dhe për këtë nuk ka asnjë dallim mes një besimtari të Allahut të Madhëruar dhe një mohuesi, mes një njëhsuesi të Lartësuarit dhe një idhujtari të Tij, mes adhuruesit të statujave dhe gurëve dhe atij që adhuron vetëm Zotin e Lartësuar. Të gjithë janë të bindur për të vërtetën e vdekjes! Të gjithë e kanë pranuar dhe e pranojnë se vdekja është e vërteta e pashmangshme dhe se me të vërtetën e vdekjes Allahu i Madhëruar ka nënshtruar robërit e Tij "dhe robërit e Tij i gjunjëzoi me vdekje dhe shkatërrim"[3].

Pra, ne jemi para një realiteti nga i cili nuk mund të shpëtojmë, për të cilin nuk mund të debatohet, sepse njeriu

3 Nga duaja e mëngjesit të prijësit të besimtarëve Ali ibn Ebi Talibit (Paqja qoftë mbi të!).

sido që ta ketë besimin dhe nivelin e mendimit të tij, edhe nëse është i lidhur pas një feje apo jo, nuk ka asnjë dyshim se ai do të vdesë.

Vetëm se ai duhet patjetër të bëjë një pyetje të madhe esenciale për këtë të vërtetë:

ÇFARË KA PAS VDEKJES?

Ç'ndodh pas vdekjes? Çfarë do të ndodhë me ne, me vëllezërit dhe të afërmit tanë që kanë vdekur që kur ka ekzistuar kjo botë, ku kanë shkuar ata? Çfarë i pret ata? Çfarë ndodh pas mbarimit të kësaj bote? Çfarë do të ndodhë pas shkatërrimit të këtij universi?

Njerëzimi dhe shkencëtarët janë të bindur se ky univers po shkon drejt shkatërrimit, drejt shuarjes së tij të natyrshme. Por çfarë ndodh pas kësaj?

Nga gjithë njerëzit me arsye dhe logjikë dihet se njeriu një ditë do të vdesë. Çdo ditë vdesin njerëz dhe ne i shikojmë kufomat e tyre. Shpirti del nga trupi i njeriut, i cili ka mundësi të jetë me organe të shëndosha të pa sëmura dhe që nuk është ankuar nga ndonjë problem shëndetësor apo çrregullim, por i erdhi vdekja dhe nxori prej tij shpirtin. Dhe ne ndodhemi përpara një kufome.

Kësaj kufome i bëjnë funeralin dhe i kryejnë obligimet fetare sipas fesë përkatëse, e varrosin. Nga ky moment prej atij nuk ka më asnjë lajm.

PO ÇFARË NDODH ME KËTË KUFOMË QË U VARROS?

Gjithashtu, ne e dimë se ky trup, pas një periudhe kohore, do të shkrihet dhe do ta hanë krimbat dhe insektet. Prej tij nuk mbetet gjë tjetër, veç skeletit të kockave. Pas një periudhe më të gjatë nuk do t'i mbetet gjë tjetër, përveçse disa eshtra të kalbura[4] dhe pas një periudhe tjetër edhe më të gjatë kohe, mbase nuk mbetet asgjë prej tij veç pak pluhur dheu, kurse të afërmit e këtij të vdekuri nuk do bëjnë gjë tjetër, veç të kthehen për të pritur ngushëllimet, të kujtojnë të vdekurin e tyre për disa ditë ose disa javë. Më pas edhe ata do të vazhdojnë jetën e tyre normale. Ndryshe jeta nuk do të kishte vazhdimësi dhe kjo është e ditur për të gjithë.

4 Eshtrat e kalbura janë eshtrat e vjetra shumë dhe shprehja është këputur nga thënia e Allahut të Madhëruar kur ka folur për disa mohuesa të çështjes së ringjalljes së të vdekurve në thënien e Tij: **"Ata (idhujtarët në dynja) thonë: "A thua do të bëhemi përsëri kështu si jemi? A edhe pasi të jemi bërë eshtra të kalbur?"**

PO ME SHPIRTIN ÇFARË NDODH?

A vdes edhe shpirti së bashku me trupin që braktisi, apo vazhdon të jetë i gjallë, me llogjikë, i ndjeshëm? A vazhdon të përceptojë atë që ndodh rreth tij? A e ndjen ai dhimbjen, mërzinë dhe gëzimin?

Në ç'gjendje ndodhet shpirti? Ku shkon ai? Ku banon? Ku qëndron? Cili është fati i tij? Pyetje të tilla, pasohen edhe nga të tjera, si: A ka një botë tjetër pas vdekjes? Cila është kjo botë? Cilat janë gjendjet e kësaj bote? Cilat janë situatat e saj? Cilat janë ligjet, peshoret dhe sjelljet e saj? A është ajo si bota jonë, apo ndryshon prej saj? A ka ndonjë lidhje mes botës sonë dhe asaj bote? A do të ketë llogari në atë botë, apo jo? E nëse ne do të japim llogari, a do të jetë ajo për diçka që ne e kemi bërë në këtë botë, apo për çfarë? Këto pyetje të shumta janë pyetje të ligjshme dhe të njohura.

Këto dhe të tjera pyetje meritojnë të trajtohen me kujdes, me meditim të gjatë, si dhe me një studim të thellë, real dhe serioz, sepse lidhen me fatin e secilit prej nesh, me fatin e njerëzve të dashur, të afërt, me prindërit,motrat, vëllezërit etj.

NEVOJAT E NJOHJES ME BOTËN TJETËR

Studimi për ç'ndodh në Botën Tjetër, në Botën pas vdekjes është një çështje e domosdoshme, sepse ajo lidhet me fatin e njeriut. Ky studim nuk është një përpjekje e thjeshtë. Ky studim bëhet për një çështje që lidhet me fatin dhe me jetën njerëzore në këtë botë, me mirësinë, ose ndëshkimin e përjetshëm, me paqen, sigurinë dhe shëndetin tonë. Për këto arsye ky studim është një hulumtim deçiziv, mbi të cilin duhet të klasifikohen veprat, veprimet, masat, planet, programet e një udhëtimi të gjatë, sa ç'është një jetë njerëzore.

E çuditshme është se ky është një problem që përfshin të gjithë, besimtarët dhe jobesimtarët, sepse ne, panvarësisht se e dimë mirë se askush prej nesh nuk do të jetojë në jetën e kësaj bote përgjithmonë. Njerëzit arrijnë të jetojnë vetëm disa vite, madje për disa nga ne jeta mund të zgjasë vetëm disa çaste, aq sa do Allahu i Madhëruar. Mirëpo njerëzit, harrojnë se janë kaq të përkohshëm në këtë botë dhe studiojnë, specializohen dhe hulumtojnë, bëjmë tregti dhe punojnë, ndërtojnë shtëpitë, grumbullojnë gjërat me vlerë, martohen, shpërblehen me fëmijë, kërkojnë të jenë të fortë dhe energjikë, kërkojnë poste dhe fuqi për të mbrojtur veten e tyre, të sigurojnë veten dhe familjet e tyre, interesohen për shëndetin e tyre, përpiqen për të siguruar luksin e të tjera si

këto, do me thënë, e harxhojnë të gjithë energjinë e tyre për përmirësimin e kësaj jete të shkurtër.

Kurse për jetën tjetër, e cila do të vazhdojë miliona e milona vite, pra, e përjetshme, ne nuk gjejmë kohë të punojmë për të! A nuk kemi kohë të mendojmë për të? A nuk kemi kohë që të mos përgatitemi për të? A nuk duhet t'u ndërtojmë veteve tona një banesë në të? A të mos mbjellim në të kopshte? A të mos përgatisim për veten tonë siguri brenda saj, paqe, prestigj, luks, repsekt, forcë, fisnikëri dhe një pozitë të lartë?

Ndëshkimi i Xhehennemit është prezent edhe aty, aq sa nuk mund t'i shkojë në mendje askujt, a nuk duhet të punojmë që t'i largohemi atij. Në qoftë se ne nuk kujdesemi që gjatë kësaj jete të shkurtër për t'i shërbyer Botës Tjetër, Botës së Përjetshme, cili do mund të shpëtonte nga fatkeqësitë e saj?

Kjo është një sjellje alogjike e njeriut, një sjellje që nuk kujdeset as për minimumin e interesit dhe dobisë personale.

Nëse dikush vjen dhe ju thotë se një tërmet i fortë do ta godasë vendin ku ti banon brenda një viti ose dy vitesh dhe do të shkatërrojë gjithçka, atëherë çfarë do të bësh ti? Pa dyshim se njeriu do të fillojë të mendojë menjëherë që të blejë një shtëpi në një zonë tjetër dhe të largohet nga ajo zonë, madje mundësisht ta braktisë atë pa llogaritur asnjë gjë tjetër, veç shpëtimit nga rreziku që i kanoset, duke e ditur mirë se ai është një lajm shkencor, i cili mund të ndodhë, por edhe mund të mos ndodhë. Ose, nëse i thuhet

një njeriu se në rrugën që ai zgjedh është një armik i fshehur, ose një fushë e minuar, a nuk e nxit kjo gjë atë njeri që të bëjë përgatitjet e nevojshme për të shpëtuar nga këto rreziqe që i kanosen?

Përse njeriu që kur është në Dynja nuk insiston të praktikojë për Jetën e Përjetshme, të investojë për veten e tij në atë Botë ku të ketë siguruar paqen, luksin dhe begatinë? Ne, gjatë viteve të jetës sonë, planifikojmë, studiojmë, përgatisim programe, bëjmë tregti dhe përpiqemi ditë e natë për të siguruar ushqimin, pijen dhe veshmbathjen, si dhe për të garantuar siguri dhe mbrojtje e për të larguar armikun, si dhe për të garantuar një jetë shoqërore të pranuar dhe të llogjikshme. Po për atë Botë çfarë kemi prodhuar? Çfarë kemi përgatitur për të?

Kjo është pyetja e madhe.

Do të mjaftonte që në realitet të ekzistonte vetëm supozimi i ekzistencës së një bote dhe jete pas vdekjes, që njeriu të provokohet dhe të nxitet drejt kryerjes së veprave të mira. Edhe sikur ndonjëri prej nesh nuk bindet për ekzistencën e Ahiretit dhe ekzistencën e jetës pas vdekjes, vetëm po të vihej para një supozimi për këtë negzistencë, do të ishte i mjaftueshëm, llogjikisht, që njeriu të rezervohet. Prandaj njeriu e ka për obligim të përgatitet për jetën pas vdekjes sa kohë është i gjallë, qoftë edhe supozim, sepse pas vdekjes, në mënyrë absolute nuk ka asnjë mundësi të bëjë vepra.

Ata që i besojnë Allahut të Madhëruar, emrave dhe cilësive të Tij, Fuqisë së Allahut e cila nuk ka kufi, Përsosmërisë së Tij, Ekzistencës dhe Bujarisë së Tij, Madhështisë së Tij, hakmarrjes së Tij si dhe drejtësinë e Allahut të Madhëruar, janë grupi i përfshirë në fjalën tonë, ata janë mëse të përgatitur për atë Botë të lirë dhe nuk tregohen kurrë moskokëçarës e mospërfillës.

ARGUMENTET PËR EKZISTENCËN E NJË JETE PAS VDEKJES

Ne e besojmë ekzistencën e një jete pas vdekjes si dhe ekzistencën e Botës Tjetër, se atje ka një llogaridhënie, një shpërblim dhe një ndëshkim për çdo vepër që e kryen njeriu. Ne besojmë se ka Xhennet dhe Xhehennem[5]. Nuk do

5 Në ajetet kur'anore dhe në trasmetimet e përmendura nga Ehul Bejti është përmendur shumë Ahireti bashkë me shpërblimin, ndëshkimin, Xhennetin, Zjarrin, grumbullimin dhe llogaridhënien, madje pa dyshim se përmendja e këtyre të vërtetave e kanë tejkaluar kufirin aq sa nuk ka mbetur për besimtarin në sheriatin e Pejgamberit Muhamed (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshim mbi të dhe mbi familjen e tij!) asnjë hapësirë për të dyshuar në vërtetësinë e ndodhisë së tyre. Ajo që përmendet në Kur'anin Fisnik është fjala e të Lartësuarit: **"Dhe ruajuni një dite kur askush askujt nuk do të mund t'i kryejë asgjë, kur nuk pranohet për të** (jobesimtarin) **ndonjë ndërmjetësim dhe nuk pranohet për të kompensim, e as që do të ndihmohen ata** (fajtorët)**"** [sure El-Bekare, ajeti 48] dhe thënia e Tij: **"Allahu është Ai që nuk ka tjetër Zot pos Tij, Ai patjetër do t'ju tubojë në Ditën e Gjykimit për të cilën gjë nuk ka asnjë dyshim. E kush mund të jetë më i vërtetë se Allahu në thënie?"** [Sure Nisa, ajeti 87] dhe thënia e Tij: **"S'ka dyshim se Momenti** (Kijameti) **do të vijë patjetër, Unë e kam fshehur atë plotësisht;** (do të vijë) **për t'u shpërblyer secili njeri për atë që ka bërë"** [Sure Taha, ajeti 15]. Thënia e Tij: **"Atë vend të përjetshëm** (Xhennetin) **ua kemi përcaktuar atyre që nuk duan as mendjemadhësi e as ngatërresë në tokë, e përfundim i këndshëm u takon atyre që i frikësohen Allahut"** [Sure Kasas, ajeti 83]. Ka edhe ajete të tjera të shumta që vështirë të numërohen. E sa i përket trasmetimeve të Ehli Bejtit, trasmetohet nga Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshim mbi të dhe mbi familjen e tij!) se ai ka thënë: *"Vdekja patjetër duhet të jetë, sillet vdekja me çfarë ka në të, sillet me mëshirë dhe paqe dhe udhë të bekuar drejt Xhennetit të lartësuar*

të hyj në një studim të gjatë argumentues për vërtetimin e këtyre çështjeve, sepse ajo që kërkohet këtu është thjesht përforcimi i këtyre dhuratave për t'u mbështetur mbi to. Por nuk përbën ndonjë dëm pse përmenden disa aspekte të argumentimit në kontekstin e përmendur.

Së pari, një nga konfirmimet e ekzistencës së jetës pas vdekjes është se gjatë historisë së njerëzimit janë dërguar nga Allahu i Madhëruar, 124 mijë pejgamberë, (sipas disa transmetimeve)[6].

---

për banorët e shtëpisë së përjetësisë, të cilët janë përpjekur për të dhe në të kanë mall dhe dëshirë të madhe dhe sillet vdekja bashkë me ashpërsinë, pendimin dhe udhën dëshpëruese të përhumbur drejt zjarrit të ashpër për banorët e arrogancës të cilët për të janë përpjekur dhe në të kanë mallin e tyre." [EL-Kafi, shkresa "Xhenazet" kapitulli "ennevadir" hadithi 27]. Përsëri thuhet nga ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshim mbi të dhe mbi familjen e tij!) se ai i ka thënë Ebu Dherrit: *"O Ebu Dherr, bëja llogarinë vetes tënde para se të japësh llogari se pa dyshim se është më e lehtë për ty nesër kur të japësh llogari, peshoje veten para se të peshohesh (për veprat), përgatitu për prezantimin më të madh ditën e demonstrimit, atë ditë që Allahut nuk i fshihet asnjë gjë"* [Mizanul Hikmeti, pjesa e 2, hadithi 3841], dhe përveç këtyre ka edhe shumë që përmenden në librat e trasmetimeve.

6 Janë shumica e trasmetimeve që janë tubuar për këtë numër dhe njëra prej tyre është ajo e trasmetuar në karakteristikën për Pejgamberin (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshim mbi të dhe mbi familjen e tij!) kur Ebu Dherri e ka pyetur atë për numrin e pejgamberëve e ai ka thënë: *"Njëqind mijë dhe njëqind e njëzet e katër mijë pejgamberë"* [Mizanul Hikmeti, pjesa 10, hadithi 19495]. Një tjetër hadith i tasmetuar tek El-Amali, gjithashtu prej tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshim mbi të dhe mbi familjen e tij!) se ka thënë: *"Allahu i Madhëruar ka krijuar 100 mijë dhe 124 mijë pejgamberë dhe unë jam më i nderuari ndër ta tek Allahu por nuk jam mendjemadh"* [Amalis-sudduk, këshilli i 41, had 11] etj.

Këta na kanë folur për jetën pas vdekjes. Këta 124 mijë pejgamberë kanë qenë të njohur në mesin e popujve të tyre për sinqeritetin, besnikërinë, mirësinë dhe paqen. Këtë na kanë folur për jetën pas vdekjes pasi kanë marrë lajmin prej Allahut të Madhëruar[7].

Të gjithë librat qiellorë që ua zbriti Allahu i Madhëruar pejgamberëve, na kanë lajmëruar për atë Botë dhe për atë Jetë.

---

7 Ajo që është vërtetuar dhe konfirmuar në sheriatin islam është se të gjithë pejgamberët - që nga Ademi (Paqja qoftë mbi të!) e deri tek Pejgamberi i Islamit Muhamedi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshim mbi të dhe mbi familjen e tij!) – që të gjithë janë pjesëmarrës në thirrjen e tyre që i bënin njerëzve për të besuar Allahun, në njësimin e Tij dhe besimit në Ditën e Fundit dhe Kur'ani na ka folur jo vetëm në një vend për këtë, kështu thuhet për profetin Nuh: **"Ne e patëm dërguar Nuhun te populli i vet, e ai tha: "O populli im, Adhurojeni Allahun, ju nuk keni tjetër Zoti veç Tij. Unë kam frikë për dënimin tuaj në një Ditë të Madhe"** [Sure A'raf, ajeti 59]. Për profetin Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!) thuhet: **"Dhe kur Ibrahimi tha: "Zoti im, bëje këtë një qytet sigurie dhe banorët e tij, që besuan Allahun dhe jetën tjetër, furnizoi me lloje të frutave"** [Sure Bekare, ajeti 126], kurse për profetin Jusuf (Paqja qoftë mbi të!) thuhet: **"**(Pasi iu plotësua dëshira, Jusufi tha) **Zoti im, Ti më ke thënë mua pushtet, ma mësove mua komentimin e ëndrrave, o Krijues i qiejve e i tokës, Ti je kujdestar imi në Dynja dhe në Ahiret, më bën të vdes mysliman dhe më bashko me të mirët"** [Sure Jusuf, ajeti 101]. Në gjuhën e Musait (Paqja qoftë mbi të!) thuhet fjala e tij: **"Dhe cakto për ne** (jetë) **të mirë në Dynja dhe të mirë në botën tjetër, pse vërtet ne jemi kthyer kah Ti"** [Sure A'raf, ajeti 156]. Ka dhe shumë ajete të tjera që Kur'ani ka përmendur pejgamberët e hershëm me mesazhin islam, ku e gjitha argumenton se pejgamberët e mëparshëm kanë besuar Ditën e Fundit dhe i ftonin njetëzit që ta besonin atë si dhe i paralajmëronin për të.

Kur'ani Fisnik, Libri i Përjetshëm dhe vula e librave, i cili e ka vërtetuar mrekullinë e tij me argumentet e arsyes dhe të trasmetimit, përmban afro njëmijë ajete të bekuara që flasin për Botën Tjetër si dhe ngjarjet që ndodhin në të.

Në Kur'anin Fisnik është sureja "El-Insan" që flet për jetën pas vdekjes, për jetën para Kijametit dhe pas tij, për Xhennetin, për Zjarrin dhe për Përjetësinë. Por edhe suret: "El-Xhathije", "El-Uakia", "El-Hashr", "El-Mumtehine", "Tegabun", "El-Hakka", "El-Kiame", "Tekvir", "El-Infitar", "El-Gashije", "El-Zelzeleh", "El-Karia", kanë nga një pjesë e cila flet për këtë temë.

Ajo që vërteton me siguri konfirmimin e çështjes është orientimi drejt saj i drejtësisë hyjnore. Besimi ynë ka nevojë për drejtësinë e Allahut të Madhëruar, ka nevojë që të ketë jetë pas vdekjes, sepse besimtarët dhe punëmirët në këtë botë, nga Ademi (Paqja qoftë mbi të!) e deri në Kijamet, nuk e kanë marrë shpërblimin e shumicës së veprave të tyre të mira. Ata vriten, bien dëshmorë, ndjejnë dhimbje, përballen me fatkeqësitë e kësaj jete, ndërkohë që të tjerët notojnë në mirësi. Prandaj duhet të ketë një Botë Tjetër, në të cilën të zbatohet drejtësia hyjnore, ku besimtarët ta fitojnë me meritë Ahiretin, ku të marrin shpërblimin e tyre për veprat e punëve të kryera mirë prej 124 mijë pejgamberëve dhe qindra mijëra besimtarë punëmirë dhe shehida gjatë gjithë historisë. Duhet të këtë një Botë Tjetër, një Jetë Tjetër që të marrin shpërblimin për luftën dhe përpjekjet e tyre, për plagët e tyre, për dhimbjet e tyre, ankesat e tyre, për

durimin e tyre, për llogarinë e tyre, për varfërinë e tyre, për fatkeqësinë që e kanë duruar në këtë botë me sinqeritet.

Në krahun tjetër janë zullumqarët, kriminelët, mizorët, despotët, vrasësit, të pamëshirshmit, të cilët e mbushën tokën me padrejtësi, me zullum, shkatërrim, me mizori, njësoj si Faraoni dhe Nemrudi[8], si dhe ata që kanë qenë para

8 Sa i përket Faraonit, ai është mizori i periudhës së kohes së pejgamberit Musa (Paqja qoftë mbi të!), ai bëri kryelartësi dhe i shtypi beni-israilët dhe pohoi për veten e vet se është zot, hyjni. Në shumë vende përmendet në Kur'an fjala e Tij ku thotë: "**Me të vërtetë faraoni ka ngritur kokën lart në tokë, e popullin e saj e ka grupëzuar dhe një grup prej tyre e shtyp, ashtu që djemtë e tyre ua mbyt, e gratë e tyre ua lë të jetojnë. Vërtet, ai ishte prej më shkatërrimtarëve**" [sure Kasas, ajeti 4] dhe thënia e Tij: "**A të ka ardhur ty rrëfimi i Musait? Kur Zoti i tij e pat thirrur në luginën e bekuar Tuva** (rrëzë kodrës Turi Sina). **Shko te faraoni se vërtet ai e ka tepruar. Dhe thuaj: "E ke ndër mend të pastrohesh"? Unë të udhëzoj të Zoti yt e ti t'ia kesh frikën Atij! Dhe ai ia tregoi mrekullinë e madhe. Po ai e përgënjeshtroi dhe e kundërshtoi. Pastaj u kthye prapa dhe iku me të shpejtë. I tuboi** (të gjithë të vetët) **dhe u mbajti fjalim. E u tha: "Unë jam zoti juaj më i lartë!" Atëherë, Allahu tmerrshëm e dënoi atë, për këtë të fundit dhe për atë të parën**". [sure Naziat, ajeti 15-25] dhe thënia e Tij: "**Ndërsa Ne i shpëtuam beni israilët prej vuajtjeve nënçmuese, prej faraonit. Vërtet ai ishte mizor i pakufishëm**" [Sure Duhan, ajeti 30-31], dhe shumë ajete të tjera kurse sa i përket Nemrudit, ai ishte mizori i kohës së pejgamberit Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!), një prej mbretërve të Babilonisë. Allahu i dha atij mbretërimin ndaj popullit të vet kurse ai bëri zullum dhe mizori në tokë duke pretenduar hyjninë e vet, në Kur'anin Fisnik është përmendur thënia e Tij që qoftë i Lavdëruar: "**A nuk ke arritur të dijsh për atë që ngase Allahu i kishte dhënë pushtet, ai** (Nemrudi) **polimezoi me Ibrahimin rreth Zotit të tij. Kur Ibrahimi tha: "Zoti im është Ai që jep jetë dhe vdekje"! Ai tha: "Edhe unë jap jetë dhe vdekje"! Ibrahimi tha: "Zoti im e sjell Diellin nga lindja, sille pra ti atë nga perëndimi"? Atëherë ai që nuk besoi mbeti i hutuar.**

tyre dhe pas tyre që nuk e kanë marrë ndëshkimin e tyre në Dynja. Drejtësia e Allahut e bën të domosdoshme që të ekzistojë një Botë Tjetër që këta të japin llogari dhe të ndëshkohen për krimet e tyre, për shkatërrimet e tyre, mizorinë dhe dhunën që kanë përdorur ndaj robërve të Allahut dhe krijesave të Tij. Ateherë, patjetër duhet që të ekzistojë ajo Botë dhe patjetër duhet të zgjidhet Atë Ditë!

Allahu nuk shpie në rrugë të drejtë popullin mizor." [Sure Bekare, ajeti 258].

PJESA E PARË

VARRI DHE BARZAKHU JANË SHTËPITË E PARA TË AHIRETIT

Duke iu referuar pyetjeve që kemi shtruar në prezantim themi se përgjigjjet për pyetjet e shtruara na çojnë në një konkluzion që ngrihet minimalisht mbi një bazë islamike dhe kur'anore. Në vijim do të flasim për disa prej këtyre çështjeve esenciale, pa u futur në detaje.

Së pari, ne pohojmë ekzistencën e jetës pas vdekjes. Këtë pohim e mbështesim në argumente llogjikë dhe kur'anorë.

Pohojmë edhe ekzistencën e një Bote Tjetër. Pohojmë se ne çdo ditë i afrohemi asaj Bote. Pohojmë se jeta njerëzore, jeta e çdo njeriu, nuk mbaron me vdekjen e tij, përkundrazi me vdekjen përfundon vetëm një fazë e saj. Pohojmë se njerëzimi, nga Ademi (Paqja qoftë mbi të!) e deri te krijesa e fundit, nuk mbaron deri në fundin e dynjasë, por zhvendoset në një Botë Tjetër, para se të bëhet Kijameti.

Së dyti, jeta pas vdekjes, sipas mësimeve të besimit islam ndahet në dy faza: faza e ndërmjetme dhe faza e madhe, ose e thënë ndryshe, faza përgaditore dhe faza e jetës së vërtetë

të përhershme, siç shprehet edhe dijetari Tabatabaiu, autor i tefsirit "El-Mizan": "Dynjaja vetë është shtëpia e veprës, e provimit dhe e sprovës, por ka dhe një Botë të Ndërmjetme që konsiderohet Bota e përgatitjes për llogaridhënie dhe shpërblim. Ka edhe një Botë të tretë që është Bota e Ahiretit, bota e llogarisë dhe marrjes së shpërblimit. Bota e Ndërmjetme quhet bota e Barzakhut, por që njihet ndryshe edhe si bota e varrit.

Pra, midis Jetës dhe Ahiretit, paska një fazë të ndërmjetme që emërtohet sipas terminologjisë islame si bota e Barzakhut. Bota e Barzakhut fillon nga çasti i vdekjes së njeriut dhe i largimit të tij nga kjo botë dhe zgjat deri sa Allahu të japë leje për t'u bërë Kijameti, Kijameti i Madh. Kjo fazë quhet bota e Barzakhut.

Faza e Barzakhut ndryshon sipas natyrës së situatës, nga një njeri te tjetri, ngryshon sipas historisë së periudhës kohore në të cilën ka jetuar ky njeri. Kështu, babai ynë, Ademi (Paqja qoftë mbi të!) dhe nëna jonë, Havaja (Paqja qoftë mbi të!) për shembull, janë të dy në Botën e Barzakhut që nga çasti i vdekjes së tyre. Ata vazhdojnë të jenë aty edhe në këtë çast dhe do të qëndrojnë aty derisa të bëhet Kijameti. Si rrjedhim, periudha e ndenjes së tyre në të është më e gjatë se periudha e qëndrimit të ndonjërit prej nesh. Por të gjithë do të kthehen atje, të gjithë ata që kanë vdekur dhe do të vdesin, shkojnë në Botën e Barzakhut dhe, siç e kemi treguar, ne nuk mund ta dimë se deri në ç'kufij kohorë

do të shtrihet. Këtë e di vetëm Allahu, sepse vetëm Allahu i Madhëruesh ëm e di momentin e se kur do të ndodhë Kijameti.

Fjala "Barzakh" në gjuhën arabe do të thotë: "*ndarja* dhe *pengesa* mes dy gjërave". Pra, me emërtimin "Bota e Barzakhut" kuptojmë pengesën, murin mes njerëzve që janë larguar nga kjo botë dhe Ahiretit, mes tyre dhe Kijametit. Ajo pengesë i ndalon ata që deri sa të vijë leja e Allahut për të ndodhur Kijameti i Madh. Atëhere të gjithë njerëzit, që nga Ademi (Paqja qoftë mbi të!) e deri në Kijamet nuk mund të shpërngulen drejt botës së Ahiretit, si dhe nuk mund të kthehen në dynja. Bota e Berzakhut i bllokon ata dhe i lë mes dynjasë dhe Ahiretit.

Pas Barzakhut vjen faza e dytë, faza e Kijametit të Madh dhe shpërngulja drejt Botës së Përhershme të Përjetshme. Ajo fillon kur Allahu i Madhëruar e rikthen përsëri krijimin e kësaj ekzistence dhe këtij krijimi kurse njerëzit e dëshmojnë atë që kanë lexuar në ajetet kur'anore, të skenave të Kijametit: "**Ditën kur toka shndërrohet në tjetër tokë e edhe qiejt** (në të tjerë qiej), **e ata,** (njerëzit) **të gjithë dalin sheshazi para Allahut, Një, të vetëm e Mbizotërues"**[9]**,** kur Allahu i Madhëruar i ringjall të gjitha krijesat dhe i sjell në shkretëtirën e Mahsherit për të dhënë llogari. Këtu fillojnë ngjarjet e Ahiretit të Madh apo të Kijametit të Madh.

[9] Sure "Ibrahim", ajeti 48.

ARGUMENTIMI PËR EKZISTENCËN E BOTËS SË BARZAKHUT

Dijetarët dhe komentuesit e Kur'anit, në argumentimin e tyre për Barzakhun janë mbështetur tek ajetet e Librit Fisnik.

I Lartësuari ka thënë: "**E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë**: "**O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira e ta kompesoj atë që lëshova!" Kurrsesi**, (kthim nuk ka) **e kjo është vetëm fjalë që e thotë ai, e ata kanë para tyre një perde** (distancë periodike) **deri në ditën kur të ringjallen. E kur i fryhet surit** (herën e dytë), **atëherë, në Atë Ditë nuk do të ketë lidhje familjare mes tyre e as që do të pyesë kush për njëri-tjetrin**" (Sure "Mu'minun", ajetet 99-101).

Ajetet këtu tregojnë se njeriun e godet një agoni në çastin kur kupton se shpirti i tij ka filluar të largohet prej tij, ka filluar fazën e largimit nga dynjaja duke i folur Allahut të Madhëruar: "O Zoti im, më kthe!" Njeriu në këtë fazë e ka kuptuar rrezikun që po i vjen. Ai mëson se jeta mbaroi dhe shanset për të bërë vepra mbaruan dhe se ai do të shpërngulet në një shtëpi tjetër. Ai ka dëshmuar gjendjen e agonisë së tij dhe proçesin e marrjes së shpirtit të tij dhe ka filluar që t'i zbulohen para syve të vërtetat e Botës Tjetër. Këtë e përmendin edhe trasmetimet, edhe engjujt e të tjera

gjëra. Ai tani ndjen ndodhinë e fatit, caktimit përfundimtar. Kështu që përgjërohet që t'i jepet një shans për t'u rikthyer në dynja. E gjitha kjo i paraprin fazës së Ahiretit, fazës së hyrjes në Xhennet ose në Xhehennem. Madje kjo çështje fillon në fazën e agonisë kur njeriu thotë: "**Zoti im, më kthe. Mbase do veproj vepra të mira tani e tutje**".

Në këtë moment i vjen përgjigjia: "**Kurrsesi, jo! Vërtet ajo është një fjalë e atij që e thotë dhe ata para tyre kanë një perde** (distancë periodike**), deri në ditën kur do të ringjallen.**" Do me thënë se njeriu, nga çasti vdekjes së tij e deri në çastin e ringjalljes, është në një botë të veçantë dhe në një zonë Barzakhu: "... **dhe në çastin që i fryhet surit** (për së dyti)" kur krijesat ringjallen përsëri "... **atëherë, në Atë Ditë nuk do të ketë lidhje familjare mes tyre e as që do të pyesë kush për njëri-tjetrin.**" Ata shkojnë drejt shkretëtirës së Mahsherit për të dhënë llogari.

Atëherë njeriu kalon nga Faza e vdekjes në të Ringjalljes së tij për llogaridhënie duke kaluar nëpër Fazën transferuese që është Faza e Barzakhut. Këtë transformim e argumentojmë qartazi trasmetime dhe ajete të shumta që kanë trajtuar analiza të detajuara për këtë botë dhe për këtë transformim. Këtu do t'i përmendim ato në mënyrë të përqëndruar për të vënë bazat e temës që diskutojmë.

NJË ANALIZË PËR FAZAT E BOTËS SË BARZAKHUT

Në fillim do citojmë një çështje ideologjike e cila është vërtetuar tek ne. Për këtë çështje kanë gjetur konsensin e plotë shumica e muslimanëve. Vetëm një numër i vogël dijetarësh nuk kanë qënë dakort me shumicen konsensuale. Kjo çështje tregon se Allahu i Madhëruar, kur i vdekuri futet në varr, i dërgon dy melaike fisnike[10] të cilët e pyesin

10 Trasmetimet janë të dakordësuara se kur njeriu zbritet në varr, i vijnë dy engjëj dhe e pyesin atë për Zotin e tij, fenë dhe pejgamberin e tij, madje edhe çështjet e përgjithshme të jetës së tij ideologjike dhe vepruese dhe sipas asaj që thuhet emrat e dy melaikeve janë Munkeri dhe Nekiri; thuhet nga Imam Sexhadi (Paqja qoftë mbi të!) se ai ka thënë duke këshilluar: *"Kur të ketë ardhur exheli dhe meleku i vdekjes ta merr shpirtin dhe dërgohesh në banesën e fundit i vetmuar, të kthehet edhe një herë shpirti dhe aty brenda të sulmojnë dy melekët, Munkeri dhe Nekiri për të të marrë në pyetje dhe për provimin e vështirë. Pyetja e parë që të bëjnë është për Zotin tënd që ti ke adhuruar, për pejgamberin që është dërguar tek ti dhe për fenë tënde që ke pasur dhe për librin që ke pas lexuar si dhe për imamin që i ke shkuar pas. Pastaj për jetën se si e ke jetuar, për pasurinë se si e ke fituar dhe shpenzuar, prandaj ki kujdes dhe shikoje veten tënde dhe përgatitu për t'u përgjigjur para se të pyetesh dhe të testohesh."* [Mizanul Hikmeti, pjesa 8, faq 3278, had 16259].

Përmendet edhe nga Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: *"Kur besimtari vdes, atë e shoqërojnë në varrin e tij 70 mijë melaike dhe kur futet në varr, i vjen Munkeri dhe Nekiri, qëndrojnë me të dhe i thonë atij: Kush është Zoti yt? Cila është feja jote? Kush është pejgamberi yt? Dhe ai (besimtari) thotë: Zoti im është Allahu, Muhamedi është pejgamberi im dhe feja ime është Islami dhe kështu ata ia zgjerojnë varrin aq sa kap syri i tij dhe i sjellin ushqim*

atë për çështje thelbësore: e pyesin për Zotin e tij, për fenë dhe pejgamberin e tij. Në qoftë se i vdekuri përgjigjet drejtë, nën dritën e veprave dhe pozitës së tij në dynja, ai pranohet se është prej punëmirëve. Atëherë dy engjujt (melekët), sipas trasmetimeve, e dorëzojnë atë tek engjëjt e mëshirës.

Në qoftë se i vdekuri belbëzon, nuk jep përgjigje, apo flet dhe tregon pozitën e tij të keqe në dynja, atëherë dy engjujt ia dorëzojnë engjëjve të ndëshkimit dhe ndodh ajo çfarë ndodh me të në varr[11].

---

nga Xhenneti dhe fusin brenda tij kënaqsinë dhe qetësinë". [Amalis –Sudduk, këshilli i 48, h. 12]. Dhe për të përcaktuar atë që pyetet robi në varr, Imam SADIKU (Paqja qoftë mbi të!) thotë: "*I vdekuri pyetet për pesë gjëra në varrin e vet: për namazin e tij, zekatin, haxhin dhe agjërimin e tij si dhe për mbrojtjen e Ehli Bejtit, kurse mbrojtja në anë të varrit u thotë katër të tjerave: çfarëdo lloj mangësie të keni ju, është detyra ime t'ua plotësoj atë".* [EL-Kafi, kap "El-Xhenaiz"]. Pjesa: "*Çështja në varr dhe kush pyetet dhe kush nuk pyetet"*.[h. 15]. është e qartë nga konteksti i trasmetimeve të tjera se ajo çfarë pyetet i vdekuri në varrin e tij nuk kufizohet me çështjet e kufizuara në këtë trasmetim, përkundrazi, trasmetimi sikurse përmend, i vdekuri nuk pyetet më tepër duke shtuar pyetjes së tij për Zotin e tij, fenë dhe pejgamberin e tij, Allahu e din më mirë. Ka edhe trasmetime të trajtuara për çështjen e pyetjes së të vdekurit në varrin e tij që nuk mund të kufizohet prandaj mjaftohemi me atë që kemi cituar.

11 Ajo përmendet në analiza që ndryshojnë nga një trasmetim në tjetrin, por në përgjithësi ajo tregon vetëm një kuptim, sikurse citohet në analizën e kësaj thënia e Imam Sadikut: "*Dy melekët, Munkeri dhe Nekiri vijnë tek i vdekuri kur varroset, zërat e tyre janë si bubullima kurse shikimi si vetëtima rrëmbyese duke e gdhendur tokën me dhëmbët e tyre dhe shtrohen në perceptimin e tyre dhe e pyesin të vdekurin: Kush është Zoti yt dhe çfarë feje ke? thotë, e nëse ai ka qenë besimtar thotë, Allahu është Zoti im dhe feja imë është islami, kurse ata të dy i thonë: çfarë ke për të thënë për atë burrë i cili erdhi nga mesi juaj? ai thotë: A për Muhamedin, të Dërguarin e Allahut po më pyesni? Ata i thonë atij a dëshmon se ai është i Dërguari i Allahut? Ai thotë dëshmoj se ai është i Dërguari i Allahut, kurse ata të dy i thonë atij, fli me një*

Me të vërtetë ai është një çast i shumë i vështirë, vendimtar dhe fatal. Në në bazë të përgjigjeve që jep i vdekuri përcaktohet fati i tij, përcaktohet se në cilën rradhë do të çohet ai, në rradhën e lumturisë e të bagatisë, i ndarë nga format, detajet dhe titujt e tij në Barzakh, apo në rradhën e mjerimit, ndëshkimit dhe poshtërimit, i ndarë gjithashtu nga përmasat dhe detajet e tij. Se si do jetë ai në Botën e Barzakhut e tregojnë trasmetimet.

Pas kësaj njeriu qëndron në Fazën e vështirësisë dhe të tmerrit të madh që është faza e orëve dhe ditëve të para në varr.

Shumica e njerëzve e ka provuar të transferohet nga një vend në një tjetër, nga një qytet në një qytet tjetër brenda një

---

gjumë pa ëndrra dhe i zgjerohet varri nëntë pash dhe i hapet një derë e Xhennetit dhe shikon vendin e tij brenda tij, por nëse njeriu ka qenë jobesimtar ata të dy futen tek ai dhe thërritet shejtani para tij me sytë si zjarr pa tym dhe ata (engjëjt) i thonë atij(njeriut): Kush është Zoti yt, çfarë feje ke dhe çfarë di për atë burrë që ka dalë nga mesi juaj? Kurse ai thotë unë nuk e di, e atëherë ata ia lërojnë rrugën mes tij dhe shejtanit dhe në varrin e tij i jepet pushtet 99 dragonjve që sikur edhe një dragua i vetëm do të frynte në tokë, nuk do të mbinte kurrë më asnjë pemë dhe i hapet një derë e Zjarrit dhe shikon vendin e tij në të" hadithi 7]. Fjala e Imamit tonë Bakirit (Paqja qoftë mbi të!) kur është pyetur se për çfarë pyeten përgjegjësit në varr, ka thënë: "*Pyetet për argumentin që është i vendosur mes shpatullave tuaja dhe i thuhet besimtarit çfarë ke për të thënë për filanin të birin e filanit, kurse ai thotë është imami im e atij i thuhet fli, Allahu të vëntë në gjumë dhe i hapet një derë e Xhennetit e i dhurohet nga qetësia dhe kënaqësia e tij deri në Kijamet, kurse jobesimtarit i thuhet çfarë ke për të thënë për filanin të birin e filanit; ai thotë kam dëgjuar për të por nuk e di çfarë është, i thuhet ti nuk e din dhe i hapet një derë e Zjarrit e ai vazhdon ta shijojë nxehtësinë e tij deri në Kijamet*" [El-Kafi, libri i "EL-Xhenaiz", kapitulli "Çështja në varr, cili pyetet dhe nuk pyetet" h. 8]. Përveç këtyre ka edhe trasmetime të tjera.

shteti, apo të largohet edhe në shtete të tjerë. Në këto raste, kur njeriu përballet me ndryshimin e mjedisit, të banesës, të komshinjve, i duhet një periudhë e gjatë kohe që të përshtatet. Gjatë kohës së përshtatjes ai për një periudhë kohe qëndron i frikësuar dhe i pasigurtë në atë vend me ato banorë të tjerë. Po si mund të jetë situata e njeriut kur ai vdes, e lë dynjanë dhe kalon në Ahiret? Pa dyshim se ai përballet me një gjendje të panjohur fare. Atë e kaplon agonia, tmerri dhe frika që fillojnë që me marrjen e shpirtit dhe vdekjen, pastaj me zhvendosjen në atë shtëpi të re. Vetëm kaq kanë mjaftuar që të qanin pejgamberët, imamët, dijetarët dhe njerëzit punëmirë kur i kujtonin ato çaste.

Kalimi në varr është kalimi nga bota e mëshirës drejt gropës së ngushtë, të cilën prijësi i besimtarëve Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) e ka përshkruar me thënien e tij: "*Kjo është humnerë, të cilës, edhe nëse i zgjerohet hapësira, ose duart e rrëmihësve e bëjnë të gjerë dhe të hapur, gurët dhe plisat e argjilës do ta ngushtojnë dhe dheu i shembur do t'i mbyllë vrimat e tij.*"[12] Ky është transferimi drejt shtëpisë së pazakontë të frikës dhe të tmerrit, drejt shtëpisë së krimbave, të terrorit dhe të panikut ku njeriu ngryset i vetmuar dhe i huaj, i braktisur pa asnjë ndihmëtar. Fjala e tij nuk dëgjohet, edhe nëse flet. Ai nuk ka asnjë forcë për të bërë asnjë vepër që ta ndryshojë gjendjen e tij dhe ta zëvendësojë me një situatë më të mirë.

12 Nehxhul Belaga, kapitulli "Shkresat, letrat, premtimet dhe këshillat e tij" Letra nr. 45, letër që ia ka shkruar Othman bin Hunejfi El-Ensariju".

Ajo është shtëpia e pafuqisë dhe e varfërisë absolute. Burimi i gjithë kësaj gjendjeje është varri.

Në Botën Tjetër të vërtetat shfaqen hapur. Njeriu kur është në dynja, mund të mendojë se është i fortë, i pasur, plot autoriret etj. Por ka gabuar rëndë dhe këtë e kupton kur shkon në Botën Tjetër. Atje ai kupton se paska qënë i varfër, injorant, i dobët dhe paska qënë begatia e Allahut të Madhëruar që i dha atij dituri, pasuri, begati e mirësi! Atje, në Botën Tjetër të vërtetat zbulohen hapur, shfaqet hapur pafuqia e njeriut dhe varfëria, injoranca dhe dobësia e tij në mënyrën më të qartë.

Kësaj i shtohet edhe kjo çështje, e cila është e përmendur në trasmetime. Shtohet çështja e ngushtimit të varrit në ditët apo orët e para, kur njeriu zbret në varrin e tij. Ky çast quhet ndryshe "përqafimi i varrit". Nga ngushtimi i varrit përjashtohet vetëm një pakicë e vogël. Për këtë çështje ka disa trasmetimeve[13] të cituara tek Synitët, Shiitët dhe gjithë

13 Shtypja e varrit – ose shtrëngimi i varrit sikurse përmendet në disa tekste – është prej mësimeve të pandryshueshme të sheriatit islam, i paraqitet sikurse e ka përmendur edhe autori, shumicës dërrmuese të krijesave dhe vetëm një pakicë e vogël shpëton, për këtë ka folur edhe Ehli Bejti dhe për shumë gjëra që citohet prej tyre. Një prej tyre është thënia e Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) për llogarinë e njeriut në varr, ka thënë: *"Ai pyetet duke qenë i shtrënguar"*. [El-Kafi, kap. "El-Xhenaizu", kap "Çështja në varr ai që pyetet dhe nuk pyetet", h. 5]. Ka edhe një thënie tjetër nga ai (Paqja qoftë mbi të!) kur dikush e ka pyetur: *"A shpëton kush nga shtypja dhe shtrëngimi i varrit?"* Ai ka thënë: *"I lutem Allahut dhe i kërkojmë ndihmë prej saj, sa të paktë janë ata që shpëtojnë prej shtrëngimit të varrit"*. [El-Kafi, kap. "El-Xhenaizu" pjesa e "Çështja në varr kush pyetet dhe kush nuk pyetet", hadith 6].

muslimanët, megjithatë kjo është nga çështjet që duhet të shihet me kujdes, me imtësi dhe detaje, sikurse bën edhe ajeti që e filluam me: "...**i ruhet** (dënimit të) **Botës Tjetër...**"[14] Varri është një prej shtëpive të Ahiretit, madje ajo është shtëpia e parë e Ahiretit.

Po si do të vazhdojë më tej, pasi engjujt e marrin në pyetje të vdekurin dhe e cilësojnë atë nga banorët e Zjarrit apo Xhennetit? Ku do të shkojnë njerëzit pas kësaj? Për këtë çështje ka një debat shkencor, në të cilin janë shtruar mendime filozofike, teologjike dhe kur'anore, të cilat nuk mund t'i shpalosim këtu për shkak të hapësirës së ngushtë, por ne do të nxjerrim prej tyre vlerën bindëse dhe kontribuese, dakordësimin e arritur duke patur si argument ajetet kur'anore dhe disa trasmetime autentike.

[14] Sure "Zumer", ajeti 9.

NDARJA E KRIJESAVE NË BOTËN E BARZAKHUT

Nga shumica e argumenteve përftohet ndarja në grupe e njerëzve në Barzakh. Grupi i parë është ai i të ndëshkuarve, të cilëve nuk u ofrohet rehati e mirësi. Grupi i dytë është grupi i atyre që u jepet mirësi dhe nuk ndëshkohen, kurse grupi i tretë është një grup ndërmjet këtyre të dyve, të cilën do ta trajtojmë.

Ata që i përkasin grupit të parë sapo shpërngulen nga kjo dynja, i marrin engjujt me dhunë, terror dhe ndëshkime të formave të ndryshme. Por cilët janë këta?

Para se t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje le të shohim pak burimin kur'anor, i cili përmend detajin e ndëshkimit që kaplon këtë grup. Në Kur'anin Fisnik flitet për çështjen e pejgamberit të Allahut, Musait (Paqja qoftë mbi të!) dhe Faraonit. Këtu përmendet një thënie për analizën e gjendjes së këtij grupi. I Lartësuari duke folur për Musain (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "**Dhe Allahu e shpëtoi atë,** (besimtarin), **prej të këqijave që i kurdisën, ndërsa ithtarët e Faraonit i përfshiu dënimi i keq.**"[15] Më pas Allahu i Mdhëruar ia bashkangjit kësaj thënieje të Tij një detaj të

15 Sure "Gafir", ajeti 45.

kuptimit të dënimit të keq dhe e ndan atë në dy pjesë: e para është ajo që citohet në thënien e Tij:

"**Ata i nënshtrohen zjarrit mëngjes e mbrëmje**"[16] kurse e dyta është thënia e Tij: "...**e Ditën e Kijametit,** (u thuhet engjëjve): '**Ithtarët e Faraonit futni në dënimin më të rëndë!**"[17]

Pra, grupi i parë i nënshtrohet dënimit të parë që është zjarri në Botën e Barzakhut, kurse dënimi i dytë është: Ditën e Kijametit ata do të hyjnë në të dhe nuk do të dalin prej tij. Gjithmonë do të jenë në dënimin e rëndë të Kijametit.

Mirëpo mund të pyetet se mbi ç'argumente mbështetet futja e njerëzve në grupin e parë? Dijetarët dhe komentuesit e Kur'anit thonë se përgjigjen e kësaj e ka konteksti i parë, i cili është citimi i ajetit për çështjen e mëngjesit dhe darkës. Dijetarët e kanë sqaruar se Xhehennemi i Kijametit të Madh, do me thënë Xhehennemi i përhershëm, nuk ka as mëngjes dhe as darkë, kurse ajeti për të cilin diskutojmë argumenton qartë për nënshtrimin nga zjarri mëngjes e darkë. Nga ky sqarim ne kuptojmë se ky dënim realizohet para zhvendosjes në Xhehennemin e Ahiretit.

Konteksti tjetër është thënia e Allahut të Madhëruar: "... **e Ditën e Kijametit,** (u thuhet engjëjve): '**Ithtarët e Faraonit futni në dënimin më të rëndë!**" Kjo tregon qartazi se Kijameti akoma s'është bërë, kurse nënshtrimi ndaj zjarrit bëhet para se të bëhet Kijameti. Pra, njerëzit i nënshtrohen

16 Sure "Gafir", ajeti 46.
17 Sure "Gafir", ajeti 46.

zjarrit mëngjes e mbrëmje para ndodhjes së Kijametit dhe, kur të bëhet Kijameti, Allahu i Madhëruar thotë në atë moment: "**Ithtarët e Faraonit futni në dënimin më të rëndë!**"

Tani le t'i kthehemi përgjigjes së pyetjes se kush është grupi i parë? Këtu nuk është specifikuar Faraoni në mënyrë të veçantë, por fjalia përfshin faraonët, nemrudët dhe mizorët në të gjitha kohërat. Përfshin Ebu Xhehlin[18], Ebu Lehebin[19], udhëheqësit kurejshë, të cilët e kanë luftuar të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe, sipas komentimit të trasmetimeve, përfshin ata që kanë mohuar me të vërtetë,

18 Ai është Amr bin Hashim bin El-Mugire nga fisi Kenane, ka qenë një nga fisnikët e kurejshëve gjatë kohës së shfaqjes së Islamit dhe ai pati deklaruar hapur refuzimin e tij ndaj Islamit madje ka qenë një nga armiqtë më të egër të Pejgamberit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshim mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe ndjekësve të tij. Mbiemri i tij origjinal ishte Ebul Hakem, mirëpo i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshim mbi të dhe mbi familjen e tij!) i vuri atij epitetin Ebu Xhehli sepse vrau një grua të moshuar për shkak se ajo deklaroi hapur Islamin.

19 Ai është Abdul Iza bin Abdul Mutalib, xhaxhai i Pejgamberit Muhamed (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshim mbi të dhe mbi familjen e tij!), epiteti i tij i parë ishte Ebu Atabe, prej djalit të madh që quhej Atabe, mirëpo Abdul Mutalibi i vuri atij epitetin Ebu Leheb prej bukurisë dhe shkëlqimit të fytyrës së tij. Ka qenë i pari që deklaroi hapur armiqësinë ndaj Islamit kur Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshim mbi të dhe mbi familjen e tij!) doli haptazi në thirrjen e tij. Ai është përmendur në Kur'an në suren "Mesed" ku thotë i Madhërishmi: "**Qoftë i shkatërruar Ebi Lehebi, e ai më është i shkatërruar! Atij nuk i bëri dobi pasuria e vet, as ajo çka fitoi! Ai do të hyjë në një zjarr të ndezur flakë. E edhe gruaja e tij, ajo që barti dru, e në qafën e saj ajo ka një litar të përdredhur**" [sure "Mesed", ajeti 1-5].

do me thënë që kanë mohuar haptas, që mizoria, padrejtësia dhe tirania e tyre është e qartë.[20]

Ata që janë në këtë gjendje, kurrë nuk do të gjejnë qetësi, sepse ata kanë zgjedhur si Xhennet, dynjanë e vet. Imam Hyseni (Paqja qoftë mbi të!), lidhur me këtë çështje, thotë se vërtet ai në dynja është mbreti i kalasë dhe i begatisë, është mbreti i torturuesve dhe i njerëzve. Ata janë të ngrënë, të pirë, të kënaqur dhe e kanë përdorë pasurinë edhe për të kënaqur pasionet dhe epshet e tyre. Të gjitha këto përfundojnë pas vdekjes dhe, që në çastin e parë që u merret shpirti, ata hyjnë në dënim, terror, poshtërim dhe dëshpërim.

Ky ajet konkludon në disa çështje: ai tregon dhe argumenton se ekziston një fazë e mesme. Kjo është Faza e

20 Një sasi trasmetimesh të cituara nga Ehli Bejti na tregojnë një çështje që pyetja e dy melekëve në varr dhe ajo që i lexohet atij nga sa thuhet në trasmetimet e mëparshme i shtrohet vetëm dy lloje njerëzish, ata janë ata që e kanë besimin të pastër dhe ata që e kanë mohimin të pastër dhe këto janë grupet e para për të cilat na tregon autori. Për këtë, përmendet nga Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: *"Në varr pyeten vetëm ata që kanë besuar vërtetë sinqerisht dhe ata që kanë mohuar vërtetë kurse të tjerët nuk merren parasysh"* [El-Kafi, libri "El-Xhanizu", kapitulli "Çështja në varr kush pyetet dhe kush nuk pyetet", h. 1]. Përmendet gjithashtu, prej tij (Paqaj qoftë mbi të!): *"Me të vërtet, në varr pyeten vetëm ata që kanë besuar siqerisht dhe ata që kanë mohuar me të vërtetë, kurse të tjerët lihen mënjanë."* [El-Kafi, libri "El-Xhenaizu", kap. "Çështja në varr, kush pyetet dhe kush nuk pyetet" h. 2]. Si dhe ajo që thuhet nga babai i tij Imam Bakir (Paqja qoftë mbi të!): *"Në varr pyetet vetëm ata që kanë besuar me të vërtetë dhe ata që kanë mohuar me zemër kurse të tjerët lihen mënjanë."* [El-Kafi, libri "El-Xhenaizu" kap. "Çështja në varr, kush pyetet dhe kush nuk pyetet", h. 3].

Barzakhut, e cila tregon për ekzistencën e një jete në këtë botë, sepse dënimi nuk bëhet për sende, por për të gjallët. Gjithashtu, konkludon edhe ekzistencën e një zjarri të Barzakhut, përveç Xhehennemit që njihet, ashtu si edhe dënimi në botën e Barzakhut nuk krahasohet me dënimin e pritshëm të Ditës së Kijametit.

Ai është një shqetësim më i vogël, pasi, në të kundërt, përse thuhet që Ditën e Kijametit, të futen ithtarët e Faraonit në dënim më të ashpër, në qoftë se dënimi i Ditës së Kijametit nuk do të ishte më i ashpër se ai i Barzakhut?

Këtu po tregojmë se është fjala për të vërtetën e begatisë dhe të mirësisë së Kijametit e që ajo është në një shkallë më të lartë se e Barzakhut. Në trasmetime thuhet se të dënuarit në Barzakh thonë: "Zoti ynë, mos e bëj Kijametin", sepse ata e shohin se çfarë fati i pret dhe e kuptojnë që është më i keq dënimi[21]. E kundërta ndodh me ata që u është dhënë mirësi në Barzakh. Ata thonë: "Zoti ynë, bëje sa më parë Kijametin", sepse ata janë të kënaqur me mirësitë dhe gëzohen me ato mirësi që janë më të shumta e më të mëdha se sa aty ku janë, në Barzakh.[22]

---

21 Citohet nga Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) se ai ka thënë: "*Me të vërtetë, shpirtrat e jobesimtarëve kur i nënshtrohen zjarrit të Xhehennemit thonë Zoti ynë mos e bëj Kijametin, mos bëj me ne atë që Ti ke premtuar dhe mos e shoqëro të fundit tonë me të parin tonë.*" [shiko Mizanul Hikmeti, pjesa 1, had 1694].

22 Thuhet përsëri prej tij (Paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: "*Shpirtrat e besimtarëve janë në dhoma të mëdha në Xhennet, hajnë prej ushqimit të tij dhe pijnë pijet e tij, ata e vizitojnë njëri-tjetrin dhe thonë: Zoti ynë bëje për ne*

Grupi i dytë, sipas trasmetimeve,[23] përfshin ata që kanë besuar me pastërti, ata që besimin e tyre në dynja e kanë patur të pastër, të sinqertë dhe të dlirë. Të tillë janë pejgamberët, të dërguarit, këshilluesit për mirë dhe të mbrojturit prej gjynahut. Të tillë janë edhe shehidët, për të cilët do të qëndrojmë pak dhe të tregojmë situatat e tyre sipas ajeteve kur'anore. Pra, grupit të dytë, pa asnjë diskutim, u jepet mirësi që në çastin e parë të shpërnguljes së tyre nga kjo Dynja. Ata shkojnë drejt mirësive dhe kënaqësive të Allahut të Madhëruar, drejt sigurisë dhe garancisë së Allahut, drejt faljes, paqes, bujarisë dhe asaj që Allahu i Madhëruar ka përgatitur për ata.

kijametin që të na dhurosh ato që Ti na ke premtuar.", [Shiko Mizanul Hikmeti, pjesa e 1, h. 1689].

23 Shiko trasmetimet e cituara në fusnotën e mëparshme kur shkëlqësia e tij ka përmendur grupimin e parë.

NJË NDALESË PËR GJENDJEN E SHEHIDAVE NË BARZAKH

Në ajetet kur'anore në lidhje me këtë çështje citohet kjo deklaratë e bukur e shkëputur nga Libri i Përsosur i Allahut të Madhëruar: "**E për ata që u mbytën në rrugën e Allahut mos thoni: 'Janë të vdekur.**"[24] Kjo deklaratë u përmend edhe në fjalimin drejtuar njerëzve nga koha e Pejgamberit të fundit Muhamedit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e deri më sot e deri sa të bëhet Kijameti. Ajeti ka zbritur në kontekstin udhërrëfyes hyjnor dhe i ndalon njerëzit që t'i konsiderojnë këta njerëz "të vdekur njësoj si të tjerët". Njerëzit udhëzohen që këta njerëz të llogariten të gjallë, para bërjes së Kijametit. Këta janë të gjallë. "**Jo, ata janë të gjallë, por ju nuk e kuptoni** (gjallërinë e tyre)."[25]

Ka edhe një ajet tjetër më të qartë, në të njëjtin kontekst, ku Allahu i Madhëruar thotë: "**Kurrsesi të mos mendoni se janë të vdekur ata që ranë dëshmorë në rrugën e Allahut. Përkundrazi, ata janë të gjallë duke u ushqyer te Zoti i tyre**"[26] do me thënë, se ata janë të gjallë tani dhe furnizimi i tyre i përmendur me qëllim, nuk e ka kuptimin për të ngrënit, të pirit dhe pasurinë konkrete. Përkundrazi, kuptimi është figurativ. Ata furnizohen me begati

24 Sure "Bekare", ajeti 154.
25 Sure "Bekare", ajeti 154.
26 Sure "Ali Imran", ajeti 169.

(qeramete) dhe grada të larta, me siguri dhe paqe, me fisnikëri dhe forcë, me kënaqësi, qetësi, rehati, mirësi dhe mbrojtje dhe me shumë e shumë gjëra të tjera. "**Përkundrazi, ata janë të gjallë te Zoti i tyre duke u ushqyer. Janë të gëzuar me atë që u dha Allahu nga mirësitë e Tij**"[27], kurse në këto çaste ata, "**janë të gëzuar**"[28]. Me kë dhe nga se janë të gëzuar ata? Ata janë të gëzuar për vëllezërit e tyre, për shokët, për të dashurit dhe miqtë e tyre, të cilët vazhdojnë të jetojnë në shtëpinë e dynjasë, dhe ata u thërrasin atyre duke u thënë: "O ju, vëllezër, që jeni akoma gjallë në dynja, o banorë të dynjasë, sikur ta dini ju se në ç'mirësi dhe bukuri jemi ne dhe në ç'dritë, në ç'paqe dhe begati jemi, me kë dhe afër kujt jemi, nuk do ta ngushtonit veten tuaj dhe nuk do të duronit për të qëndruar në dynja, qoftë edhe një çast të vetëm. Mirëpo ju nuk mund të shihni, jeni të pavëmendshëm dhe harraqë: "... **dhe atyre që kanë mbetur ende pa iu bashkuar rradhëve të tyre, ata i përgëzojnë**"[29] Ata janë të qetë për ju se do të vazhdoni rrugën tonë dhe do të shpërbleheni, në dashtë Allahu, me dëshminë ashtu sikurse u furnizuam ne me të, "...**për ta nuk ka as frikë dhe as që kanë pse të brengosen**. **Ata janë të gëzuar me begati e dhurata që ua dha Allahu, e s'ka dyshim se Allahu nuk ua humb shpërblimin besimtarëve**"[30].

27 Sure "Ali Imran", ajetet 169-170.
28 Sure "Ali-Imran", ajeti 170.
29 Sure "Ali Imran", ajeti 170.
30 Sure "Ali Imran", ajetet 170-171.

FJALA PËR GRUPIN E TRETË

Trasmetimet dhe mendimet e dijetarëve për këtë grup janë të ndryshme. Mendime të ndryshme gjenden edhe brenda një medh'hebi. Për shkak se ky studim është shkencor, intelektual dhe doktrinal dhe ka nevojë për shumë debat, atëherë unë nuk do të mbështetem në dhënien e një rezultati definitiv, por do të mjaftohem me paraqitjen e disa opinioneve.

Disa prej dijetarëve mendojnë se pasi grupi i tretë merret në pyetje nga engjujt, në lidhje me atë se çfarë ndodh me ta në varr, zgjerim apo shtrëngim varri, gëzim apo hidhërim, atëherë, pa dyshim, ata lihen mënjanë dhe engjujt nuk kthehen më të merren me ta. Por ata, (dijetarët), nuk e kanë sqaruar mirë me detaje kuptimin e kësaj situate.

Ka edhe një thënie tjetër, ku tregohet se disa të tjerë mendojnë dhe konsiderojnë se nëse i vdekuri është prej njerëzve punëmirë, por jo në gradën e grupit të dytë, (ata që kanë besuar sinqerisht), atëherë ai bie në gjumë dhe engjujt i hapin atij një dritare në varrin e tij, ose një prej portave të Xhennetit dhe atij i vjen aroma e tij, qetësia dhe lumturia e Xhennetit. Por Allahu është Ai që e di se çfarë i vjen atij në atë kohë. Ai fle dhe zgjohet deri në çastin kur i fryhet surit, kur Allahu i Madhëruar jep leje që të bëhet Kijameti. E njëjta gjë thuhet edhe për ata që janë njerëz të ligj, jo të gradës së

grupit të parë, (për ata që kanë mohuar sinqerisht), të cilëve u hapet një gropë ose një dritare e Xhehennemit dhe i jepet diçka nga zjarri i tij, nxehtësia dhe errësira e tij.

Ka edhe një mendim tjetër që tregon se nuk ka asnjë dallim mes grupit të parë e të dytë, sepse rregulli dhe ligji thotë se varri i çdo njeriu është ose një kopësht prej kopshteve të Xhennetit, ose një gropë prej gropave të Xhehennemit. Por ka një dallim për shkallën e dënimit të këtyre, ose për mirësinë ndaj tyre, sepse dënimi i tyre nuk është si dënimi i grupit të parë. Edhe bekimi i tyre me mirësi, nuk është si ai i grupit të dytë.

Nga ky citim lind një pyetje për ata, të cilëve u jepet mirësi prej njerëzve të grupit të dytë, (shehidat dhe pejgamberët). Pyetja është: a furnizohen ata me mirësi në varret e tyre aq sa varret e tyre të shndërrohen në kopështe si kopshtet e Xhennetit? A është gjendja e atyre si e atyre që janë mëshiruar prej grupit të tretë, apo atje mund të ketë Xhennete Barzakhije ku ata mblidhen dhe kënaqen me mirësi?

A dënohen njerëzit e grupit të parë në varret e tyre duke ua shndërruar ata në gropa Xhehennemi, apo atje ka zjarr, apo zjarre Barzakhije ku futen njerëz të tillë?

Kjo analizë ndërthur trasmetime, mendime dhe thënie të ndryshme.

NJË KËSHILLË PËR VETEN DHE PËR BESIMTARËT

Duke marrë shkas nga vërtetësia e secilit prej tre mendimeve, dua të tregoj se mjafton vetëm supozimi i vërtetësisë së mendimit të tretë, se vërtet mjafton që të ketë një mundësi që fjala e fundit të jetë ajo që thuhet se me të vërtetë: Çdo varr është një kopësht prej kopshteve të Xhennetit, ose një gropë prej gropave të Xhehennemit dhe se mëshira apo mjerimi i ardhur nga Allahu fillon me vdekjen, por që, në përputhje me gjendjen në Barzakh, është i ndryshëm nga ajo që do të ndodhë në Kijamet.

Mjafton vetëm kjo hipotezë që të na bëjë ne të jetojmë një situatë të frikshme, të tmerrshme, një situatë shumë shqetësuese. Në fund të fundit që të gjithë ne i ekspozohemi vdekjes, në çdo çast dhe në çdo vend, pasi njeriu mund të vdesë në një vend dhe një kohë kur ai dhe askush tjetër nuk e pret. Që të gjithë ne do të vdesim, e Allahu i Madhëruar i flet Pejgamberit të Tij më të nderuar (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) duke i thënë: "**Me të vërtetë, ti** (Muhamed) **je i vdekur dhe pa dyshim se edhe ata janë të vdekur**"[31] Ndërkohë që ai, (Muhamedi), është krijesa më e dashur tek Ai. Pra, që të gjithë ne do ta arrijmë Barzakhun dhe do të shkojmë në varrin ku do të qëndrojmë aty qindra, mijëra apo dhjetra mijëra vite, sepse askush nuk e di kohën, momentin kur do bëhet Kijameti.

31 Sure "Zumer", ajeti 30.

Supozimi i tretë është i mundur në kuptimin logjik dhe mendor. Atë e argumenton një numër trasmetimesh dhe disa ajete. Por çfarë kemi përgatitur ne për të dhe a jemi të gatshëm?

Ky Barzakh (fjala jonë tani është e kufizuar në temën e Barzakhut dhe më pas të trajtojmë Kijametin e Madh dhe jetën e përhershme atje), ky varr, është shtëpia e errësirës, shtëpia e kurbetit, e vetmisë, e tmerrit, e urisë, e varfërisë. Çfarë kemi përgatitur ne për të?

Kjo pyetje e madhe kërkon prej nesh si individë dhe si bashkësi që të ulemi, të mendojmë, të vërejmë me kujdes, të studiojmë, të planifikojmë, të programojmë, të punojmë dhe të ndjekim ditë e natë, të shfrytëzojmë çdo minutë, çdo sekondë, çdo çast dhe çdo ditë të jetës sonë që të veprojmë për të realizuar, përgatitur dhe furnizuar për Botën Tjetër, ashtu siç punojmë për t'u përgatitur për luftë, ashtu siç përpiqemi për të zgjidhur situatat tona të vështira ekonomike, jetësore, shoqërore, politike e sigurie, ashtu siç planifikojmë martesën, studimin dhe mënyrën e marrjes së një profesioni. Të gjitha këto na marrin neve kohë, megjithëse u kushtohemi punëve të kësaj bote ku jemi për pak kohë. Po për Botën e Përhershme ç'kemi përgatitur? Me ç'vepra të mira përgatitemi për të shkuar atje? Se vetëm veprat e mira janë ato që do të mbeten me ne atje!

Përmendet në një lajm të trasmetuar nga Ehli Bejti (Paqja qoftë mbi ta!)[32] se njeriu, pasi vdes, shikon pasurinë e vet. Kjo ndodh në çastin e vdekjes, ose kur i vjen dhe i thotë pasurisë: "Ti je ajo që ma harxhove jetën time për të të grumbulluar dhe kursyer, me hallall dhe haram.

Mua tani më ka rënë fatkeqësia dhe para meje kam një udhëtim të gjatë. Po çfarë do të përfitoj prej teje?" Pasuria e tij i thotë: "Prej meje do të marrësh qefinin, vetëm qefinin, kurse pasurinë që mbetet do ta marrin trashëgimtarët."

32 Lajmi citohet në librin Shexheretu Tuuba të muhadithit të madh shejkh Muhamed Mehdi el-Hairi pos prejardhjes së tij nga Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshim mbi të dhe mbi familjen e tij!) apo njërit prej imamëve, përmbajtja e tij është: *"Të birit të Ademit i përngjaset në kohën e agonisë pasuria fëmijët dhe vepra dhe ai kthehet nga pasuria e tij dhe i thotë: "Unë kam qenë i kujdesshëm shumë në grumbullimin tënd sa në tokë e në det, në të ftohtë e në të nxehtë për të të fituar ty dhe unë sot po ndahem prej teje por kam nevojë për ndihmën dhe mbështetjen tënde, çfarë do bësh? si do të më ndihmosh mua? pasuria thotë: 'merr prej meje qefinin tënd dhe shko në varrin tënd, këtë e thotë edhe fjala e Allahut të Madhëruar:* "**dhe mos harro atë që të takon nga kjo botë**" *[sure Kasas, ajeti 77] e ai është qefini. Pastaj kthehet nga djemtë e tij dhe thotë: Për Zotin e kam lodhur veten dhe shpirtin për ju, kam mbledhur para për ju, hallall dhe haram, u mbylla në kërkesat e saj dhe kam duruar vështirësitë dhe gjëra të urryera për të ruajtur pozitat tuaja dhe për të kryer nevojat tuaja, por unë sot kam shumë nevojë për ju prandaj më ndihmoni sa të mundni, kurse ata thonë: ne të shoqërojmë ty deri te varri dhe gropa jote, të japim lamtumirën aty e pasi të lëmë ty atje, ne kthehemi në shtëpitë dhe banesat tona. e kur ai dëshpërohet prej pasurisë dhe fëmijëve, ai kthehet nga vepra e mirë dhe thotë: Pasha Allahun unë të kam urryer ty dhe largohesha nga ti, kam përtuar të veproj ty, tani unë mbeta vetëm fillikat, nuk më ndihmon as pasuria dhe as fëmija nuk më mbron, po ti çfarë do bësh me mua? Vepra thotë: Unë jam me ty dhe nuk do të të lë vetëm kudo që të shkosh, unë jam para teje, jam shoqëruesi dhe shoku yt dhe ai gëzohet me këtë".* [shiko Shexheretu Tuba, mexhlisi 39].

Njeriu do të pyetet si e bëri këtë pasuri, prej hallallit, apo haramit, por trashëgimtarët janë ata që do ta gëzojnë këtë pasuri në këtë Dynja me forma të ndryshme. Pastaj ai shikon fëmijët, familjarët dhe dashamirët e tij, e thotë: "Unë ju kam dhënë juve bukë e ujë, ju kam mësuar dhe edukuar, ju kam mbrojtur, ju kam mbajtur në krahë. Çfarë do përfitoj prej jush?" Ata thonë: "Ne do të bartim ty në krahë dhe do të të shoqërojmë në gropën tënde" Pra, njeriu nuk merr prej tyre asgjë, veç bartjes për të mos e lënë në rrugë që të përhapet era e kufomës. Pastaj pas kësaj, atij i vjen dikush dhe ai e pyet: "Kush je ti?" Ky, pasi është braktisur nga pasuria e tij, nga fëmijët e tij, të dashurit dhe familjarët e tij, sheh se i vjen kjo gjë që i ngjitet e nuk do që të largohet prej tij. Ai e pyet: "Kush je ti, ç'lidhje ke ti me mua dhe ku të kam parë ty? A të njoh unë ty, apo jo? Ai i thotë: "Po, unë jam vepra jote dhe nuk do të ndahem për asnjë çast, do jem vetëm me ty."

Nëse kjo është vepër e mirë do të jetë ndihmë, mbështetje, përfitim dhe shpëtim për atë njeri. Por, nëse është vepër e keqe, e shëmtuar, gjynah, mizori, shkatërrim, do ta dëmtojë shumë këtë njeri dhe vetëm Allahu i Madhëruar është Ai që, nëse do, e ndihmon atë.

Në mbyllje të pjesës së parë, deklarojmë se ne, pa dyshim që e besojmë ekzistencën e Botës së Barzakhut, besojmë edhe jetën e Barzakhut, në të cilën ka edhe lumturi, edhe dënim dhe begatitë e saj sa që mund të krahasohen me shpërblimet më të mira të dynjasë. Megjithatë, nuk ka

dyshim se shpërblimi dhe dënimi i Ahiretit është shumë herë më i madh. Vetëm se kjo botë, e cila mbaron me bërjen e Kijametit, ka ekuilibrat dhe ligjet e saj specifike. Shtylla kryesore e saj është vepra dhe thënia për ndërmjetësimin e pejgamberëve (Paqja qoftë mbi ta!) për gjynahqarët dhe të pabindurit. Është edhe ndërmjetësimi i Ehli Bejtit, ndërmjetësimi i shehidëve, (Allahu qoftë i kënaqur me ta!). Ne besojnë se këta kanë një pozitë dhe gradë tek Allahu i Madhëruar, i Cili i autorizon ata të ndërmjetësojnë për të tjerët. Unë them se është i rëndësishëm edhe besimi në burimin e ndërmjetësimit. Vetëm se duhet thënë se trasmetimet, hadithet dhe thëniet e dijetarëve kanë treguar se në Botën e Barzakhut nuk ka asnjë ndërmjetësim, prandaj nuk të ndihmon edhe sikur të thuash se unë jam prindi i një shehidi, apo biri i një shehidi. Kjo nuk bën asnjë dobi. E vetmja gjë që bën dobi, është vepra e mirë, si edhe në Ahiret, në të cilin fillon të veprojë parimi i ndërmjetësimit. Aty hapen dyert e mëshirës hyjnore, por vetëm Allahu e di masën e përhapjes së mëshirës së Tij në Atë Ditë. Prandaj Bota e Barzakhut është një botë e vështirë, e cila nuk duhet nënvlerësuar, prandaj trasmetimet janë orientuar drejt saj, prandaj tregohet se vetëm në Ditën e Kijametit është e mundur që të ndihmojnë njëri-tjetrin, (kurse në Barzakh kjo nuk ndodh), prandaj njeriu duhet të përpiqet për veten e tij dhe të punojë shumë për të, sepse mbështetja e tij në Atë Botë do të jenë vetëm veprat e tij dhe ajo që ai ka përgatitur prej veprave të mira, si adhurimet, bamirësitë,

devotshmëria, mirësia, lufta në rrugë të Allahut, sinqeriteti, pastërtia dhe dlirësia.

Njeriu ndodhet në një udhëtim të gjatë, i cili ka nevojë për shumë përgatitje dhe gjëra që do ta ndihmojnë dhe mbështesin në atë udhëtim. Për analogji të përafërt, mund të sjellim shembullin, kur edhe në këtë botë ndodhemi para një udhëtimi, kemi nevojë për përgatitje për atë udhëtim. P. sh, kur udhëtojmë në zonat malore, duhet të jesh i pajisur me gjëra që nevojiten për udhëtim malor, si: rroba, mjete transporti, ushqim, pije. Ndërsa në diskutimin tonë flasim për një udhëtim tepër të gjatë, me qindra e mijëra vite. Këtë natyrë ka ky udhëtim, këto ligje dhe ekuilibra ka, prandaj duhen sa më shumë rezerva dhe pajisje. Me fjalë më të qarta, shtojini sa më shumë të mirat, shtoni sa më shumë veprat e mira, adhurimet, devotshmërinë, Allahu ju mëshiroftë!

PJESA E DYTË

FUNDI I UDHËTIMIT

SITUATAT E RËNDA TË KIJAMETIT TË MADH DHE TMERRET E TIJ

Po e vazhdojmë temën tonë për çështjen e jetës pas vdekjes, për Ditën e Kijametit, për ngjarjet e Asaj Dite përmes kësaj trajtese të shkurtër, duke u ndalur vetëm në disa detaje të disa titujve, kurse detajet tjera do t'i përmbledhim.

Në këtë hulumtim do të mbështetemi kryesisht në ajetet kur'anore, sepse Kur'ani Fisnik është burimi më i besueshëm, në të cilin mund të mbështetësh për trajtimin e Asaj Dite. Ajo Ditë është lajmi i dijes së fshehtë, e cila mund të mësohet vetëm përmes burimeve të sigurta.

Para se të thellohemi në analizën e studiuesit dhe prezantimin e kërkesave të tij, do ta prezantoj shkurtimisht studimin, përmes të cilit kërkoj të gjej në të një lidhje me temën e trajtimit, apo për kuptimin e çështjeve kur'anore në përgjithësi.

PREZANTIM:

PËRDORIMI GJUHËSOR NDËRMJET TË VËRTETËS DHE METAFORËS

Të gjithë ne e dimë se Allahu i Madhëruar e ka zbritur Kur'anin Fisnik në gjuhën arabe, prandaj ai që dëshiron të kuptojë qartë Kur'anin dhe domethëniet e ajeteve të tij fisnike, duhet të jetë njohës i gjuhës arabe dhe i pasurive leksikore, morfologjike dhe sintaksore të saj. Kjo është e domosdoshme për të kuptuar tekstin, kontekstin dhe konotacionet e fjalëve dhe të fjalive, si dhe lëvizjet kuptimore, shprehësitë stilistike etj, me të cilat vishet mendimi.

Gjuhëtarët arabë i kanë ndarë përdorimet e gjuhësoro-stilistike në dy pjesë: Një fjali e caktuar, herë përdoret me një kuptim, herë me një ngarkesë tjetër kuptimore. P.sh, ne e përdorim fjalën "*mal*" për të treguar një vend të ngitur lart, të veshur me pyje etj, e përdorim "*hëna*" për të treguar yllin e vogël që ndjek tokën, që ndriçon natën dhe që rrotullohet rreth tokës, e përdorim fjalën "*deti*" për të treguar një hapësirë të madhe plot ujë, në të cilën lundrojnë anijet, etj, e përdorim fjalën "*luan*", për të treguar një kafshë të fortë të pyllit.

Fjalët: "mal, hënë, det dhe luan" janë përdorë me kuptimin e tyre të parë, me kuptimin leksikor themelor, të vërtetë, konkret dhe real.

Shpesh herë, si rezultat i lëvizjes kuptimore të fjalës, fitohen kuptime të dyta, të treta dhe më shumë (varësisht pasurive shprehëse stilistikore të gjuhës përkatëse dhe aftësisë së përdoruesit të gjuhës. Për hir të së vërtetës duhet thënë se gjuha arabe është një ndër gjuhët më të pasura në këtë drejtim, për të mos thënë, më e pasura.). Çdo lëvizje kuptimore dhe çdo kuptim i ri që fiton fjala, mban lidhje me kuptimin e parë. Mbështetor në shtresëzimet kuptimore të reja që fiton fjal, të cilat mbartin edhe lidhjen që thamë, por fitojnë edhe konotacione të reja kuptimore, na krijohet mundësia që të përdorim edhe kuptime të dyta..., në vend të kuptimit të parë. Për shembull, nëse ne shikojmë një njeri të fuqishëm të vendosur, themi "pashë një mal". Kjo fjali nuk nënkupton malin e përbërë nga dheu dhe rëra, por nënkupton njeriun e fuqishëm që qëndron si malet. Këto përdorime ua shtojnë vlerat, bukurinë dhe forcën shprehëse nderitmeve gjuhësore.

Këto përftesa stilistikore, këto stilema nuk përdoren për të treguar kuptimet e tyre të para, por kuptime të tjera, kuptime të figurshme. Këto përdorime stilistikore quhen "përdorime metaforike", sepse në bazë të ndërtimit të kuptimit të ri, qëndron lëvizja kuptimore me lidhjet e saj përkatëse. Ky ndërtim krijon figurën letrare, bazë. Ajo quhet "Metaforë"

Përdorimet e figurshme metaforike janë të preferuara nga linguistët, shkrimtarët, poetët e përdorues të tjerë të gjuhës. Për të qënë të kuptueshme kuptimet metaforike, ato duhet të kenë lidhje me një kontekst të caktuar, i cili është i njohur për lexuesin, dëgjuesin.

E VËRTETA DHE METAFORA NË KUR'ANIN FISNIK:

Sqarimi i mësipërm është i nevojshëm, veçanërisht, kur kemi në dorë Kur'anin, i cili është një model i shkëlqyer i retorikës dhe i larmisë së pasurive stilistikore. Në të ka përdorim të vërtetë dhe metaforik, pasi jo të gjitha shprehjet e pëdorura bartin kuptimet e vërteta, prandaj duhet të vërehet me imtësi. Si shembull për këtë shërben thënia e Allahut të Madhëruar: "**E kush ka qenë i verbër në këtë** (botë), **ai do të jetë edhe në Botën Tjetër i verbër dhe më i humburi i rrugës së drejtë.**"[33] Dihet nga të gjithë se fjala "*i verbër*" (A'ma), në kuptimin e parë tregon personin që ka humbur aftësinë e të shikuarit, ose ka lindur i tillë, por në këtë shembull, fjala "i verbër" nuk përdret me kuptimin e saj të parë. Këtu kjo fjalë përdoret si metaforë, e cila tregon njeriun me zemër të pandjeshme, "me zemër të verbër", që ka hubur nga rruga e drejtë.

Në disa ajete ndeshim fjalinë: "**Dora e Allahut është mbi duart e tyre.**",[34] mirëpo ne e besojmë se Allahu i Madhërueshëm nuk ka trup dhe se Atij nuk i përngjan asgjë, e dimë se fjala "*dorë*" në përdorimin e vërtetë tregon një gjymtyrë të trupit të njeriut. Allahu i Madhëruar nuk ka

33 Sure "Isra", ajeti 72.
34 Sure "Fet'h", ajeti 10.

gjymtyrë si të njerëzve. Fjala "dorë" nuk është përdorë me kuptimin e saj të parë, por me kuptimin e figurshëm, me kuptimin metaforik, i cili përcjell mesazhin e fuqisë dhe të gjithpushtetit të Allahut.

Gjuha arabe është një gjuhë elokuente dhe e hapur për përdorime të ndryshme. Kur'ani zbriti në këtë gjuhë, prandaj shprehjet e disa ajeteve duhet t'i lidhim me kuptimet e tyre të vërteta, kurse një pjesë tjetër duhet t'i lidhim me kuptime metaforike, nëse ekziston një lidhje kuptimore që e lidh atë kuptim me kontekstet përkatëse.

TREGUESIT E KIJAMETIT TË MADH DHE NGJARJET QË NDODHIN NË TË

Tani i referohemi temës që po trajtojmë, pra, çështjes së ardhjes së Kijametit e që është dhe faza e madhe e fundit.

Që në fillim themi se kohën se kur do të bëhet Kijametit e di vetëm Allahu i Madhëruar.[35] Ajo i përket diturive të

35 Ajo që përmend shkëlqësia e tij këtu është e konfirmuar dhe e përmendur në mënyrë të qartë në tekstin e Kur'anit Fisnik sikurse trasmetohet edhe nga Ehli Bejti, ndërsa në Kur'an, njëra prej tyre është thënia e Allahut të Madhëruar: "**Ata që përgënjeshtruan se do të takohen me Allahun** (në Ditën e Gjykimit) **kanë humbur. Derisa t'u vijë Momenti** (Kijameti) **befas e atëherë do të thonë: "Të mjerët ne për atë që lëshuam** (nga punët e mira në Dynja) **dhe ata do t'i bartin gabimet e veta në shpinë. Sa e shëmtuar është ajo që bartin**" [sureja "En'am", ajeti 31] dhe thënia e Tij: "**Të pyesin ty** (Muhamed**) për Çastin** (katastrofën e përgjithshme) **se kur do të ndodhë ai. Thuaj: "Atë e di vetëm Zoti im, kohën e tij nuk mund ta zbulojë kush pos Tij** (e sjell Kijametin pa e hetuar asnjë nga krijesat). **Çështja e tij** (se kur do të ndodhë) **është preokupim i rëndë** (për krijesat) **në qiej e në tokë. Ai** (katastrofa) **nuk ju vjen ndryshe, vetëm befas. Të pyesin ty sikur ti di për të. Thuaj: "Për të di vetëm Allahu, por shumica e njerëzve nuk dinë** (pse është e fshehtë)" [sureja "A'raf", aj 187].

Thënia e Tij: "**Nuk presin tjetër ato** (grupe) **përveç Katastrofës, t'u vijë befas duke mos e hetuar**" [sureja "Zuhruf", ajeti 66]. Ka edhe shumë tekste të tjera që përmenden në ajetet kur'anore; kurse në një trasmetim të bërë nga Ehli Bejti thuhet se ka thënë Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshim mbi të dhe mbi familjen e tij!): *"Në fund të kohës do të ketë fitne njësoj si copa, pjesë të natës shumë të errët dhe kur Allahu i Madhëruesh ëm të hidhërohet me banorët e tokës, e urdhëroj Israfilin që t'i fryjë Surit për Kijametin dhe ai i fryn ndërkohë që njerëzit janë të hutuar dhe zihen*

fshehta, të cilat Akllahu i ka veçuar vetëm për Veten e Tij. Sepse ka dituri të fshehta, të cilat Allahu ua ka treguar pejgamberëve. Të dërguarit e Tij nga ana e tyre kanë lajmëruar njerëzit, por ka edhe nga ato dije që Allahu ka veçuar Veten e Tij dhe nuk ka lajmëruar askënd prej pejgamberëve të Tij, miqve dhe engjëjve të Tij. Njëra prej tyre është koha se kur do të ndodhë Kijameti, pas një viti, pas njëqind vitesh, pas njëmijë apo dhjetëmijë vitesh. Kijameti do ndodhë befas. Kjo është një nga shenjat e tij specifike. Sipas trasmetimeve, njerëzit në kohën që do bëhet

---

në befasi; do të ketë njerëz që janë në vendin e tyre, ka prej tyre që janë nëpër tregje, do ketë prej tyre që janë në ara duke punuar, një pjesë janë në udhëtim, ka prej tyre që janë duke ngrënë aq sa nuk arrijnë ta çojnë ushqimin në gojë dhe vdes si i shtangur, ka prej tyre që po bisedon me shokun e atij dhe nuk arrin ta plotësojë fjalinë derisa vdes" [Mealimu zulfa fi meailmu dunja vel uhra]. fjalia e katërt, kap. 6, h. 8]. Njëra prej tyre është ajo që citohet në tefsirin e El Kummi, në fjalën e Allahut të Madhëruar: "(Allahu u përgjigjet) **Ata nuk janë duke pritur tjetër vetëm se një britmë që i rrëmben ata kur janë duke u zënë mes vete**" [Sure "Jasin", ajeti 49], ka thënë: Kjo ndodh në fundin e kohës, lëshohet një britmë e madhe në mesin e tyre ndërkohë që ata janë në tregjet e tyre duke u zënë me njëri-tjetrin dhe që të gjithë vdesin në vend, askush prej tyre nuk kthehet në shtëpinë e vet dhe as nuk merr ndonjë këshillë". [Tefsiri i El Kummi, komentimi i ajetit 49 të sures "Jasin"]. Autori i tefsirit el-Mizan, trasmeton në një studim trasmetues e thotë: *"Në tubimin e hadithit, kijameti bëhet e dy burra kanë hapur rrobat e tyre për t'i shitur dhe duke bërë Pazar ata nuk kanë kohë as t'i palosin se bëhet Kijameti, kurse tjetri e ka ngritur dorën e tij për të futur ushqimin në gojë dhe nuk arrin sepse bëhet Kijameti kurse tjetri që mbush rezervuarin e tij për t'i dhënë me pirë një bagëtive të tij por nuk mundet se Kijameti ka ardhur".* [el-Mizan në tefsirin e Kur'anit, komentim i ajeteve nga 48-65 të sures "Jasin", studim i tarsmetuar], etj.

Kijameti do jenë të preokupuar me çështje të jetës së tyre të përditshme dhe do t'i zërë të papërgatitur, në befasi në mënyrë të papritur.

Çfarë ngjarjesh do të ndodhin kur Allahu i Madhëruar të japë leje që të bëhet Kijameti?

Përgjigjet i gjejmë në tekstet, të cilët tregojnë se ato ngjarje ndahen në dy pjesë: një pjesë e tyre ka lidhje me gjallesat e ndryshme dhe pjesa tjetër lidhet me ne, njerëzit. Një pjesë tjetër ka lidhje me objekte jo të gjalla të universit, si: Dielli, Hëna, malet, oqeanet etj.

Karakteristika e përgjithshme dhe specifike e këtyre ngjarjeve është përhapja e frikës, e tmerrit, e poshtërimit, e habisë, e terrorit, e panikut dhe e ankthit nga të papriturat që u ka rezervuar fati. Këto ndjesi e shoqërojnë njeriun që kur fillojnë ngjarjet e deri sa të merret vendimi përfundimtar i pozicionit të tij, pra deri kur banorët të hyjnë ose në Xhennet, ose në Zjarrin e Xhehennemit.

Në fillimin e sures "Haxh" Allahu i Madhëruar thotë: "**O ju njerëz, ruajuni dënimit nga Zoti juaj, sepse dridhja e katastrofës së Kijametit është një llahtari e madhe. Atë Ditë, kur ta përjetoni Atë, secila gjidhënëse braktis atë që ka për gjiri dhe secila shtatzënë e hedh para kohe barrën e vet, ndërsa njerëzit duken të dehur. Ata nuk janë të dehur, por dënimi i Allahut është i ashpër.**"[36]

36 Sure "Haxhxh", ajetet 1 dhe 2.

SITUATA E KRIJESAVE TË GJALLA NË DITËN E KIJAMETIT

Le të vijmë tani te lloji i parë i ngjarjeve, të cilat kanë lidhje me krijesat e gjalla. Njëra prej tyre është njeriu. Kur'ani Fisnik na lajmëron se Allahu xh.sh, kur bëhet Kijameti, urdhëron për vdekjen e çdo gjallese të gjallë, njerëz, xhinde, melaike dhe kafshë. Asgjë e gjallë nuk mbetet, përveç Allahut të Madhërishëm. "**Çdo gjë që është në të,** (në tokë), **është zhdukur. E do të mbetet vetëm Fytyra e Zotit tënd, që është i Madhëruar e i Nderuar.**"[37]

Këtu nuk do të flasim vetëm për krijesat e tokës, sepse krijesa ka edhe jashtë tokës, p.sh engjëjt, të cilët gjenden edhe në tokë, edhe në qiell, ose xhindet. Të gjithë këta do t'i prekë vdekja, madje edhe të vdekurit e tokës në Botën e Barzakhut, të cilët janë të përfshirë në këtë. Allahu i Madhëruar i vdes të gjithë gjallesat në atë çast, edhe ata që ekzistojnë në Dynja, edhe ata që gjenden në Botën e Barzakhut, apo në botëra të tjera.

37 Sure "Rrahman", ajetet 26 dhe 27.

SI UA MERR JETËN ALLAHU ATYRE?

Ajetet kur'anore që i referohen kësaj teme flasin dy çështje që janë: **klithma e fortë** dhe shkatërruese, e cila arrin brenda një çasti të vetëm tek çdo gjallesë në këtë ekzistencë dhe e vdes atë dhe **fryrja e surit** (e borise) e cila përmendet në Kur'an. Allahu i Lartësuar në Librin e Tij Fisnik thotë: "**Dhe i fryhet Surit dhe bie i vdekur ç'ka në qiej dhe ç'ka në Tokë, përveç atyre që do Allahu,** (të mos vdesin), **pastaj i fryhet atij herën tjetër, dhe ja, të gjithë ata janë të ngritur dhe presin** (urdhërin e Zotit)."[38]

Suri, sipas gjuhës arabe, është një bori. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) kur është pyetur për këtë ka thënë se ajo është një bori së cilës i fryhet. Boria është një pajisje e vjetër, e përdorur që në kohën e lashtë, para shpikjes së altoparlantëve dhe përdorej në ushtri për të sinjalizuar mbledhjen apo shpërndarjen e tyre. Pra, boria është një mjet që sjell lajm.

Boria për të lajmëruar është përdorë që kur Allahu i Madhëruar krijoi Ademin (Paqja qoftë mbi të!), që para dhjetra mijëra vitesh. Madje, disa kombe vazhdojnë edhe sot e kësaj dite ta përdorin atë. Suri, pra, është boria që parathotë lajm.

38 Sure "Zumer", ajeti 68.

Mirëpo, cili është kuptimi dhe qëllimi i përdorimit të Surit, borisë për të cilën po flasim? A e njëjtë me këtë përshkrim që i bëmë ne borisë, surit, është edhe boria, suri që përdor Israfili, një nga engjëjt e mëdhenj gjigandë. Ç'buri, ç'sur do të jetë ai që do të bartë Israfili dhe a do t'i fryjë asaj Israfili (megjithëse askush nuk i di përshkrimet e saj, veçoritë fizike të saj)?. Ç'përmasa, ç'veçori fizike do të ketë ai që vetëm me zërin që lëshon arrin të vdesë çdo gjallesë në tokë[39]?

Suri është përdorim metaforik i klithmës që krijon Allahu i Madhërueshëm me Fuqinë e Tij të Pakufishme e Madhështore[40].

---

39 Shumë tarsmetime kanë folur për këtë kuptim, këtu përmendim atë që thuhet nga Imam Ali ibn Husejni (Paqja qoftë mbi ta!) kur ai ka thënë në fjalën e tij për situatat kur bëhet Kijameti: *"Allahui Madhëruar i jep urdhër Israfilit të zbresë në tokë dhe me vete ka edhe Surin. Suri ka një kokë dhe dy skaje, anë, dhe hapësira ndërmjet dy skajeve është sa ajo mes qiellit dhe tokës [...] kështu ai fryn një herë dhe del britma nga krahu i banorëve të tokës dhe nuk mbetet në tokë krijesë me shpirt pa rënë në tokë i vdekur dhe del britma nga skaji tjetër që vijon për banorët e qiejve dhe nuk mbetet asnjë shpirt në qiej vetëm se bie i vdekur përveç Israfilit dhe qëndrojnë në atë gjendje deri sa të dojë Allahu i Lartësuar"*. [Mealimu zulfa, fjalia e katërt, kap. i gjashtë, h. 1]. Përmendet nga Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshim mbi të dhe mbi familjen e tij!) se ai ka thënë: *"Në fundin e kohës, afër Kijametit fitnet, do të jenë si një natë e errët, e nëse Allahu i Madhërueshëm zemërohet me banorët e tokës e urdhëron Izrafilin që t'i fryjë Surit për t'u marrë shpirtin dhe ai i fryn Surit kur ata, njerëzit janë të hutuar, të pavëmendshëm"* [I njëjti burim, fjalia e katërt, kap. 6, h. 8]. Kjo është një tregues i qartë i kuptimit që ka përmendur shkëlqësia e tij.

40 Gjithashtu, këtë kuptim e kanë argumentuar disa trasmetime, e njëra prej tyre është ajo që citohet nga Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshim mbi të dhe mbi familjen e tij!) kur dikush e pyeti për frikën më

Këto mendime i thonë edhe dijetarët, por ajo që është e vërtetuar është rezultati i impaktit dhe rezultati është se do jetë një zë i fortë, i frikshëm e tmerrues që do arrijë çdo mendje, zemër dhe shpirt që gjendet në qiej dhe në Tokë dhe do t'i lëshojë të vdekur. Fjala "*Essaiku*" tregon "*rënien në tokë në gjendje të fikti*". Gjendja e të fiktit nuk është e thënë që të jetë në çdo rast vdekjeprurëse. Por kjo gjendje të fikti është vdekjeprurëse për të gjithë, sipas thënies së Allahut të Madhëruar: "**Dhe i fryhet surit dhe bie i vdekur ç'ka në qiej dhe ç'ka në Tokë, përveç atij që do Allahu** (të mos vdesë)" [41].

Komentuesit e Kur'anit janë ndal në thënien e Tij "**Përveç atij që do Allahu**" dhe kanë vlerësuar se disa krijesa nuk do të vdesin. Për përcaktimin e tyre kanë pasur mendime të ndryshme. Gjthësesi ata janë përcaktuar dhe janë: Xhebraili, Mikaili, Israfili dhe Azraili. Disa komentues përfshijnë edhe engjëjt e mëdhenj, disa të tjerë përfshijnë dhe shehidët.

Disa të tjerë, jo komentues të Kur'anit, mendojnë se kjo mënyrë shprehjeje është cituar vetëm si ruajtje e së drejtës dhe e shprehjes së Fuqisë Absolute, pasi në të kundërt ndodh që bie e vdekur çdo gjallesë në qiej e në Tokë, pa përjashtim. Në të gjitha situatat, pa dyshim se çdo gjë e

---

të madhe e ai ka thënë: *"Me të vërtetë njerëzve u lëshohet një britmë e vetme dhe nuk mbetet i vdekur pa u ringjallur dhe as i gjallë e të mos vdesë, përvç atij që do Allahu",* [Shiko, Mealimu zulfa, fjala e 4, kap 6, h. 2].

41 Sure "Zumer", ajeti 68.

gjallë, përveç atyre që janë të përjashtuar, nëse mendimi i parë është i vërtetë, bie, vdes dhe nuk mbetet i gjallë askush, përveç Allahut të Madhëruar.

Me sinkronizimin e kësaj ngjarjeje të lidhur me krijesat dhe gjallesat, para apo pas tij, ndodhin edhe ngjarje të tjera që kanë lidhje me ekzistencën dhe universin. Më poshtë do të përmendim një numër ajetesh që tregojnë për ato ngjarje. Po prezantojmë një përmbledhje të panoramës që të përfitojmë nga komentimi i ajeteve dhe pastaj i paraqesim ajetet. Kështu, kuptimi i ajeteve bëhet më i qartë për lexuesin.

SKENA UNIVERSALE NË KIJAMET

Çfarë ndodh në skenën universale?

Dielli, burimi i dritës, i ngrohtësisë dhe i jetës në sistemin tonë diellor dhe i shumë dobish të tjera për të gjithë ekzistencën tonë tokësore, mbështillet dhe bëhet sa një grumbull, do me thënë paloset, mbulohet dhe i fiket drita. Kur Dielli shuhet, Hënës nuk i mbetet më dritë, sepse ajo ndriçohet nga Dielli dhe të gjithë tokën e zapton errësira. Madje të gjitha sistemet diellore dhe gjithçka që ndriçohet me dritën e këtij Dielli, errësohen!

Shuhet edhe drita e yjeve dhe e planeteve të tjerë. Ata shpërndahen në hapësirë, copëtohen, bien, shkërmoqen, zbehen dhe zhduken. Ky është ai kuptimi i thënies së Allahut **"... yjet trazohen...".** Edhe shkencërisht kjo çështje është e mundur të ndodhë, sepse njihet ajo që quhet "vdekja e yjeve", apo "vdekja e planeteve".

EDHE QIELLI ÇAHET DHE COPËTOHET

Malet shemben, rrafshohen dhe shndërrohen në pluhur të dendur dhe, njësoj si dunat e rërës, i merr era dhe rrafshohen me tokën. Për ilustrim, imagjinoni sikur një mal i lartë të shkërmoqet në çast, të bëhet rërë e pluhur, të rafshohet me tokën! Kjo pamje do të ishte tejet e frikshme, do të tmerronte gjithkënd!

Toka do të dridhet shumë, do të tronditet si nga një tërmet shumë i fuqishëm. Do të nxjerrë gjithçka në barkun e saj. Nuk do të ketë më as male e as lugina. Do të jetë një tokë e shtirë, e zgjatur, e rafshët që përgatitet për t'u bërë Shkretëtira e Mahsherit, në të cilën do tubohen miliardat e njerëzimit dhe të krijesave.

Oqeanet do të shpërthejnë, do të ndizen zjarr. Ujërat do të marrin flakë dhe do të avullojnë. Nuk do të mbetet asnjë oqean, asnjë det, asnjë mal, asnjë luginë, asnjë pemë! Nuk do të mbetet asnjë shenjë jete!

Çfarë kuptojmë ne nga këto përshkrime kur'anore?

Këto ajete argumentojnë se Allahu i Madhëruar nuk e shkatërron universin, përkundrazi, Ai e përsërit edhe një herë krijimin e Tij, por sipas një rregulli dhe sistemi të ri. Ka mundësi që dikush të pyesë se si do të jetë toka pas shkatërrimit, kur thuhet se në të do të grumbullohen njerëzit për të dhënë llogari në errësirën e plotë, sepse Atë Ditë nuk ka as Diell, as Hënë e as yje. Allahu i

Madhërueshëm përgjigjet se në sisitemin e ri që krijon, do të kijojë menjëherë një dritë që ndriçon të gjithë njerëzit e Mahsherit: "**Toka është ndriçuar me dritën e Zotit të vet!**"[42].

Pra, në Ditën e Kijametit jemi para një universi të ri, një ekzistence të re si dhe një natyre të re. Në të ka tokë, dritë dhe elementë të tjerë. Në vijim, bëhet fjalë për Xhennetin dhe Xhehennemin.

Kjo ekzistencë e re, siç e përmendëm më lart, ka ligjet dhe rregullat e saj, të cilat janë të ndryshme nga ligjet e universit tonë, nga ligjet e fizikës, të kimisë, të fiziologjisë, të mjekësisë, inxhinierisë, të sportit dhe të gjithçkaje që ka lidhje me hapësirën dhe kozmosin. Ky krijim i ri është një univers i ndryshëm nga i mëparshmi, para se të ndodhë Kijameti. Për këtë Allahu i Lartësuar thotë: "**Ditën kur toka ndryshohet në tjetër tokë, e edhe qiejt** (në të tjerë qiej), **e ata,** (njerëzit), **të gjithë dalin sheshazi para Allahut, Një, Mbizotërues!**"[43] Ne, tashmë, ndodhemi përpara një toke të re, përpara qiejsh të rinj. Allahu e krijoi, apo e përsëriti krijimin e tyre, pas shkatërrimit të këtij universi.

42 Sure "Zumer", ajeti 69.
43 Sure "Ibrahim", ajeti 48.

NJË QËNDRIM SHQYRTUES PËR DËSHMITË E TESKTIT KUR'ANOR

Pasi prezantuam një panoramë të përgjithshme për gjendjen e universit Ditën e Kijametit, do të paraqesim disa dëshmi të ajeteve kur'anore me shpresën që me këtë do të plotësojmë panoramën e dhënë më lart.

Në suren "El-Vakia", Allahu i Lartësuar thotë: "**Kur toka tundet me dridhje të forta...**" Lexuesi le të imagjinojë një tërmet të lehtë të tokës dhe të përfytyrojë shkallën e tmerrit dhe të frikës që do kaplojë njerëzit. Me të vërtetë, një tërmet i vogël që përfshin një zonë, zgjat pak sekonda, por këto mjaftojnë për t'i tmerruar njerëzit, sepse ndërtesat rrëzohen rrotull tyre, kurse toka çahet poshtë tyre. Po si do ishte, vallë, nëse e gjithë toka, në një çast të vetëm, do jetë në lëkundje? Allahu e tund atë me një dridhje të fortë! Si do të jetë, vallë, skena?

"**Kur toka tundet me dridhje të forta, e kodrat shkapërdredhen e bëhen copë e thërrime, e bëhen pluhur i shpërndarë...**"[44] Ja, kjo është skena që përshkruan sureja "El-Vakia."

Në suren "Murselat" thuhet: "**S'ka dyshim se ajo që premtohet ka për të ndodhur patjetër! Kur yjet të shuhen dhe kur qielli të hapet dhe kur kodrat të copëtohen...**"[45].

44 Sure "Vakia", ajetet 4-6.
45 Sure "Murselat", ajetet 7-10.

Në suren "Hakka", ajeti 13 thuhet: "**E kur të fryhet në surë një fryrje...**". Ajo është një fryrje e vetme, por është e mjaftueshme për t'i vdekur të gjitha gjallesat. "... **dhe të ngriten toka e kodrat e ta godasin vrullshëm njëra-tjetrën me një të goditur**" Pra, gjithçka shkatërrohet jo me faza, jo me një seri tërmetesh, por vetëm me një tronditje të vetme! "**Në Atë Ditë ndodh Ndodhia e Madhe,** (Kijameti). "**E qielli çahet, pse ai Atë Ditë është i brishtë**"[46]. Përse çahet qielli, përse bëhet i brishtë dhe zbërthehet? Kjo ndodh se mbështjella atmosferike, e cila mbron lëmshin e tokës nga meteorët, yjet dhe shkëmbinjtë që biejnë nga qielli çahet. Çahet i gjithë ky qiell, shpërthen dhe hapet dhe gjithë tmerri mbulon gjithçka.

Në suren "Muzemmil" thuhet: "**Atë Ditë kur toka e kodrat të dridhen, e kodrat bëhen rërë rrëshqitëse**"[47](do me thënë bëhen copë e çikë, njësoj si dunat e rërës.)

Në suren "Inshikak" thuhet: "**Kur të pëlcasë qielli, t'i bindet urdhërit të Zotit të vet, ashtu si i takon. Dhe kur Toka të shtrihet në gjerësinë e saj, e të nxjerr ç'ka brenda e të çlirohet**"[48].

Në suren "Infitar" thuhet: "**E kur të çahet qielli dhe kur të shkapërderdhen yjet dhe kur të përzihen detet dhe kur të trazohen varret...**"[49]

46 Sure "Hakka", ajetet 13-16.
47 Sure "Muzemmil", ajeti 14.
48 Sure "Inshikak", ajetet 1-4.
49 Sure "Infitar", ajetet 1-4.

Pastaj, në suren "El-Karia": "**Krisma** (e Kijametit)" do me thënë Kijameti i shtang zemrat, mendjet dhe shpirtrat. "**Çfarë është Krisma? Dhe ç'të mësoi ty se ç'është Krisma? Ajo është kur njerëzit Atë Ditë bëhen si insekte të shpërndara**", si ato insektet e shpërndara dhe që kanë humbur rrugën në qorrsokak. "...**dhe kodrat bëhen si leshi i shprishur**", (do me thënë malet e fortifikuara bëhen si leshi i shprishur).

"...**sa i përket atij që i rëndon peshorja e veprave të tij, ai është në një jetë të këndshme. Ndërsa, atij që e ka të lehtë peshën e veprave të tij, vendi i tij do të jetë Havije. E ç'është ajo që të njoftoi se ç'është** (Havije)**? Është zjarri me nxehtësi shumë të lartë!**"[50]

Në suren "Zelzeleh" thuhet: "**Kur të dridhet toka me dridhjen e saj të fuqishme...**" (e ai është tërmeti aq i fuqishëm sa po të bashkoheshin të gjitha tërmetet e tokës, do të ishin të kota krahasuar me të) "... **dhe të nxjerrë toka atë që ka në brendinë e saj dhe njeriu të thotë: 'Ç'ka kjo** (që bën këtë dridhje)**" -** i hutuar dhe i habitur - "**Atë Ditë ajo i rrëfen tregimet e veta, ngase Zoti yt e ka urdhëruar atë. Atë Ditë njerëzit shfaqen të ndarë në grupe që të shpërblehen për veprat e tyre**"[51].

Në suren "Tekvir" thuhet: "**Kur Dielli të jetë mbështjellë** (dhe të errësohet)" Ngjarja më e madhe që ndodh Atë Ditë është shuarja e Diellit mbështjellja dhe

50 Sure "Karia", ajetet 1-11.
51 Sure, "Zelzeleh", ajetet 1-6.

mbulimi i tij. "...**dhe kur yjet të kenë rënë** (e shkapërderdhur) **dhe kur kodrat të kenë udhëtuar** (e bërë pluhur në ajër), **dhe kur devetë e shtrenjta të lihen pa bari në fushë, dhe kur egërsirat të jenë bashkuar,** (tubuar), **dhe kur detet të vlojnë si zjarr i flakëruar**" (do me thënë të gjitha vlojnë në zjarr) "**dhe kur shpirtrat të jenë bashkuar, dhe kur të pyeten ato vajza të varrosura të gjalla, për çfarë mëkati janë mbytur, dhe kur fletushkat të jenë shpalluar, dhe kur qielli të jetë hapur...**" Pra, e gjithë kjo kataklizmë është shtresa atmosferike që shpërbëhet. Fjalia "...**dhe kur Xhehennemi të jetë ndezur fort**" është një plotësim i skenës kur Xhehennemi fillon të ndizet e të vlojë duke u përgatitur për të pritur mysafirët e vet. "...**dhe kur Xhenneti të jetë afruar...**" Duhet vënë re se theksohet se Xhehennemi ndizet fort, kurse Xhenneti zbukurohet për të pritur miqtë e nderuar. "... **atë botë njeriu do ta dijë se çfarë ka ofruar...** (të mirë ose të keqe)"[52]

Pas gjithë këtyre ngjarjeve universale, të cilat mund të ndodhin të gjitha ose vetëm një pjesë e tyre, përfundon jeta e gjallesave dhe përballemi me një univers të ri. Allahu e di më së miri se sa kohë do të qëndrojmë derisa Allahu të dëshirojë një urdhër tjetër, urdhërin e ringjalljes së krijesave dhe njerëzimit për llogaridhënie. Kjo është prej çështjeve të dijes së fshehtë për të cilën Allahu i Lartësuar nuk na ka lajmëruar përmes Kur'anit Fisnik. Prandaj askush nuk është

52 Sure "Tekvir", ajetet 1-14.

i prerë dhe i sigurtë në përgjigjen e kësaj pyetjeje. Allahu i Madhëruar do ta bëjë Kijametin e Madh kur të dojë.[53]

53 Po, Kur'ani Fisnik nuk na ka lajmëruar për kohëzgjatjen ndërmjet vdekjes së njerëzve dhe ringjalljes së tyre, pasi kjo çështje konsiderohet prej dijeve të fshehta të cilat nuk i di kush pos Allahut të Madhëruar, mirëpo në disa thënie të njerëzve masuminë (të pagabueshëm) është cituar diçka që e tregon me gisht këtë çështje por pa përcaktuar afat kohor; përmendet nga Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) se ai ka thënë: *"Kur Allahu i jep fund jetës së banorëve të tokës, qëndron në atë situatë aq kohë sa ka krijuar njeriun në fillim dhe aq sa ia ka marrë jetën atyre disa herë, pastaj i vdes banorët e qiellit të dynjasë, pastaj qëndron aq kohë sa e ka krijuar në fillim njeriun dhe aq sa ka bërë të vdesë banorët e tokës dhe banorët e qiellit të dynjasë, pastaj i bën të vdesin banorët e qiellit të dytë, pastaj qëndron për aq kohë sa ka dashur në krijimin e jetës dhe aq sa i ka marrë jetën banorëve të tokës dhe banorët e qiellit të dynjasë dhe qiellit të dytë, pastaj bën të vdesin banorët e qiellit të tretë, pastaj qëndron kështu aq sa është dashur në krijimin e parë dhe aq sa është dashur në vdekjen e banorëve të tokës, banorët e qiellit të dynjasë, të qiellit të dytë dhe të qiellit të tretë, në çdo qiell ndodh kështu e shumë më shumë se aq gjë. Pastaj e vdes Mikailin, pastaj qëndron ashtu aq sa është dashur në krijimin e parë dhe si shembulli i gjithë asaj edhe shumëfish, pastaj e vdes Xhebrailin, e pastaj qëndron qëndron ashtu aq sa është dashur në krijimin e parë edhe më shumë, pastaj e vdes Israfilin dhe qëndron aq sa është dashur në krijimin e parë e edhe më shumë, pastaj e vdes melekun e vdekjes e pastaj qëndron aq sa është dashur në krijimin e parë e edhe më shumë, pastaj Allahu i Madhërueshëm thotë: "I kujt është mbretërimi sot? E Ai i përgjigjet vetë Vetes së Tij: të Allahut, të Gjithfuqishmit, Ngadhënjyesit, ku janë të fortët? Ku janë ata që më shoqëruan mua ortak? Ku janë mendjemëdhenjtë dhe të tjerët si ata? Më pas Allahu i ringjall krijesat".* [Shiko, tefsirin e El Kummi, komentimi i ajetit 16 të sures "Gafir"].

RINGJALLJA E TË VDEKURVE

Këtu do të flasim për gjendjen në të cilën gjendet njerëzimi Atë Ditë. Më sipër diskutuam për vdekjen. Tani le të flasim për përsëritjen e Ringjalljes së njerëzimit.

Biseda për çështjen e Ringjalljes ndahet në dy pjesë: e para flet për britmën e fuqishme dhe tmerruese, e cila i vdes të gjithë të gjallët kurse e dyta flet për fryrjen e Surit, e cila i ringjall të vdekurit dhe i ngre nga varret. Kjo është fryrja e Ringjalljes dhe rikthimit të jetës[54] .

Allahu i Lartësuar thotë: "**Dhe i fryhet Surit, kur ja, duke u ngutur prej varrezave paraqiten te Zoti i tyre.**"[55]

Lexuesi le ta imagjinojë pamjen e tokës të mbushur plot e përplot me varre, ndërmjet atyre që janë varrosur nëpër varre dhe atyre që janë varrosur me rënien e yjeve dhe planeteve, maleve dhe tërmeteve, që të gjithë ata janë të shtrirë në barkun e tokës.

Të rikthyerve në jetë u ringjallen trupat rishtazi dhe në to futet jeta, shpirtrat kthehen brenda tyre, hapen varret dhe

54 Lexuesi ka mundësinë që të marrë informacion në tekstet e trasmetuara të cilat i treguam në indekset e mëparshme që të shikojë se grupi i trasmetimeve që përmendin Israfilin dhe fryrjen e tij në Sur është si një faktor i vdekjes së krijesave ajo përmend gjithashtu, fryrjen e tij të dytë për të bërë ringjalljen e tyre ashtu sikurse edhe grupi që tregon edhe çështjen e britmës si faktor i vdekjes, gjithashtu, citon britmën si faktor të ringjalljes së tyre.

55 Sure "Jasin", ajeti 51.

njerëzit dalin prej tyre. Mijëra milionë njerëz, në një çast të vetëm, dalin të befasuar dhe të frikësuar.

Kjo është e mundur për Allahun dhe e llogjikshme. Madje një ringjallje ka ndodhur në kohën e mëparshme. Kjo tregohet në një trasmetim, i cili thotë se i nderuari Mesia, Isai (Paqja qoftë mbi të!) një ditë kaloi afër një varri dhe e luti Allahun e Lartësuar që ta ringjallë të vdekurin që ishte në atë varr. Allahu i Madhëruar i dha leje. Ai e thirri dhe varri u hap. I vdekuri doli nga varri dhe, kur e pa atë të thinjur, të tmerruar e të befasuar, e pyeti për kohën e pleqërisë së tij. Ai i tha se u thinj dhe u plak në çast, për shkak se mendoi se paska ardhur koha e daljes nga varri.

Po si do të jetë, vallë, dita e daljes së vërtetë?

Këtë e plotësojmë me ajetet që ka thënë i Lartësuari: "**Dhe i fryhet Surit, kur ja, duke u ngutur prej varrezave paraqiten te Zoti i tyre.**" Pra, ata shkojnë te Zoti i tyre dhe tek vendi ku ata do të tubohen. Largohen nga varret e tyre duke nxituar dhe thonë: **"Të mjerët ne! Po kush na ngriti prej varreve ku ishim shtrirë? E, kjo është ajo që premtoi Zoti dhe e vërtetuan të dërguarit."**[56]

Pejgamberët dhe të dërguarit i kanë paralajmëruar ata, por ata nuk u besuan atyre, prandaj ishin të hutuar.

"**Ajo nuk është tjetër, përveç një zë i fuqishëm dhe ata të gjithë paraqiten para Nesh.**"[57] Kjo është Madhështia e Allahut të Lartësuar. A nuk do të krijohet rrëmujë totale kur

56 Sure "Jasin", ajeti 52.
57 Sure "Jasin", ajeti 53.

të ngrihen dhe të grumbullohen miliarda e miliarda njerëz? Allahut të Madhëruar i mjafton vetëm një thirrje e vetme për t'i tubuar mijëra milionë njerëz e edhe më shumë. Ai është i Vetmi që e di numrin e tyre, që tubohen në shkretëtirën e Mahsherit.

Në një vend tjetër i Lartësuari thotë: "**Ditën kur të hapet toka e ata nguten** (për vendtubim), **e ai është një tubim i lehtë për Ne.**"[58] Toka çahet dhe ata dalin prej varreve të tyre. Dalin duke nxituar drejt atij vendi. E gjitha kjo për Allahun është shumë e lehtë.

"**Dita kur e dëgjojnë thirrjen për të vërtetën,** (Ringjalljen), **është Dita e Daljes** (prej varrezave)."[59] Të gjithë njerëzit nxitojnë nga varret e tyre drejt vendit të marrjes në pyetje dhe llogarisë së detyruar për të qëndruar përpara Allahut të Lartësuar. Ata dalin nga varret e tyre pa qefinë, përveç përjashtimeve që janë përmendur në trasmetime,[60] të zhveshur, lakuriq. Imami Zejnul Abidin

58 Sure "Kaf", ajeti 44.

59 Sure "Kaf", ajeti 42.

60 Njëra prej tyre është ajo që citohet në tefsirin e El Kummi: "Aliu (Paqja qoftë mbi të!) e ka pyetur të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshim mbi të dhe mbi familjen e tij!) për komentimin e thënies së Tij: "**Ditën kur ata të devotshmit do të tubohen te Allahu si delegacion**", ai tha: "*O Ali, pa dyshim se delegacioni vjen hipur mbi mjet, ata janë njerëz që i janë frikësuar Allahut dhe Ai i ka veçuar ata dhe është kënaqur me veprat e tyre dhe Allahu i ka quajtur ata të devotshëm, pastaj tha: O Ali, pasha Atë që ka çarë farën dhe ka krijuar frymën, nuk ka dyshim se ata do të dalin nga varret e tyre me fytyra të bardha si bardhësia e dëborës, të veshur me të bardha si bardhësia e qumështit, në këmbë kanë veshur këpucë prej floriri të zbukuruar me perla dhe smeralde*". [Tefsiri i El Kummi, komentimi

(Paqja qoftë mbi të!) thotë në lutjen e përshkrimit të gjendjes së njerëzve Atë Ditë: "Unë shikoj një herë nga e djathta ime e një herë nga e majta ime, kurse krijesat e tjera nuk janë në pozitën time."[61]

Askush nuk e shikon tjetrin dhe askujt nuk i bie ndërmend për atë që ka në krah. Secili është i angazhuar me veten e tij me zemër dhe mendje të frikësuar, i habitur dhe i befasuar, i tmerruar për fatin që e pret, për pyetjen, për llogarinë dhe qëndrimin para Zotit. Ashtu qëndrojnë shumë gjatë përpara Allahut të Lartësuar.

Ajetet kur'anore e përshkruajnë gjendjen e njerëzve në Atë Ditë kështu: "... **kur zemrat të mllefosura arrijnë në fyt...**"[62] Kjo është shprehje e një frike të madhe: "... **e zemrat arritën në fyt...**"[63] është shprehja më elokuente e arabishtes për frikën, pasi kur zemrat arrijnë fytin, të mllefosura, nuk mund të flasin dot, nuk mund të marrin frymë, vetëm me lejen e Allahut të Madhëruar. Heshtja pllakos dhe gjithkund mbizotëron tmerri.

---

i ajetit 85 i sures "Merjem"]. Ajo që citohet edhe nga Imam Kadhimi (Paqja qoftë mbi të!) se ai ka thënë: *"Ai që na do ne dhe na ndjek ne, nuk del ndryshe nga kjo dynja vetëm se Allahu, i Dërguari i Tij dhe ne jemi të kënaqur me të..."* [Mealimu zulfa, fjalia e 4, kap. 15, h. 4], si dhe trasmetime të tjera.

61 Pjesëza e cituar është marrë nga lutja e Ebu Hamza Thumali, trasmetuar nga Imam Zejnul Abidin (Paqja qoftë mbi të!) dhe përmendet në shumicën e librave të duave.

62 Sure "Gafir", ajeti 18.

63 Sure "Ah'zab", ajeti 10.

Ata qëndrojnë shumë gjatë në atë gjendje, derisa Allahu i Lartësuar të japë leje dhe të urdhërojë që të pyeten dhe të bëhet llogaria.

(Ne nuk e dimë kohëzgjatjen e Asaj Dite, sepse koncepti dhe treguesit kohorë të jetës tokësore ndryshojnë me ato të Botës Tjetër, ku dita është e ndryshme, epokat dhe vitet ndryshojnë, siç citohet në Kur'anin Fisnik).

QËNDRIMI PËRPARA ALLAHUT PËR LLOGARIDHËNIE

Askush nuk e di se sa kohë e ndan tubimin e njerëzve në Shkretëtirën e Mahsherit, ku qëndrojnë të zhveshur, lakuriq, duke kulluar djersë, të mbushur me frikë, duke u ankuar për urinë dhe etjen dhe fillimin e llogaridhënies direkte dhe të marrjes në pyetje. Siç shihet, gjendja e njerëzve në Shkretëtirën e Mahsherit përshkruhet si tejet e vështirë, prandaj edhe Dita e Kijametit është përshkruar si Dita e urisë dhe etjes së madhe, si Dita e tmerrit më të madh. I Dërguari i Allahut Muhamedi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka këmbëngulur vazhdimisht të përkujtojë Atë Ditë në hytbet e tij të njohura, sidomos, në pritje të muajit të Ramazanit. Në këto hytbe thoshte: "Përkujtojeni urinë dhe etjen tuaj në Atë Ditë, urinë e Ditës së Kijametit dhe etjen e tij".

Në kohën që do të dëshirojë Allahu i Lartësuar e ndërpret gjendja e vështirë dhe urdhëron të vijë koha e dhënies së llogarisë. Ajetet kur'anore tregojnë se vendosen peshoret, të cilat "peshojnë" fjalët që kemi thënë, "peshojnë" veprat që kemi kryer, sjelljet, karakterin, devotshmërinë dhe sinqeritetin ndaj Allahut, etj. (Ato peshore nuk duhen imagjinuar si peshoret që përdoren në përditshmërinë tonë, por duhet kuptuar se është fjala për

kuptimin metaforik) Ato peshore peshojnë çdo gjë, gjithçka! Atij që i rëndon peshorja, që i peshojnë veprat është në lartësinë dhe sinqeritetin e tij për Allahun dhe e kundërta për atë që e ka peshoren të lehtë.

Fillojnë pyetjet dhe llogaridhënia. Ato janë të ndara në llogaridhënie të individëve dhe llogaridhënie të ymeteve dhe grupimeve. Për më tepër informacion dhe detaje për temën e llogaridhënies së grupimeve dhe ymeteve, mund të shfrytëzohet libri i shkollës kur'anore të imamit, shehidit të nderuar, Muhamed Bakir Sadr, (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Çështja mbyllet me llogaridhënien e individëve.

Për gjendjen e individëve në Ditën e Kijametit lexojmë thënien e Allahut të Madhëruar: "**Dhe në Ditën e Kijametit secili do t'i paraqitet Atij i vetmuar,**".[64] Pra, i ndarë nga vëllai, babai, fëmija dhe shoku. Secili prej tyre mendon vetëm për veten e tij dhe qëndron i vetmuar për llogaridhënien para Allahut të Lartësuar. Të gjithë pejgamberët, që nga koha e Ademit (Paqja qoftë mbi të!) e deri në Kijamet, janë prezent në llogaridhënien e tij, prandaj në shumë prej lutjeve përmendet kërkesa për mbulimin e gjynaheve nga Allahu i Lartësuar, Ditën e Kijametit, të mos i trgojnë të gjitha, sepse ne kemi bërë në dynja gjynahe pa u ndrojtur dhe pa e menduar llogarinë e Ditës së Kijametit. Njeriu mund të bëjë gjynahe në fshehtësi në dynja, duke u frikësuar se mos e shikojnë familjarët e vet, komshinjtë, bashkësia e vet, partia apo banorët e vendit të tij, mirëpo

64 Sure "Merjem", ajeti 95.

Ditën e Kijametit do të ekspozohet gjithçka që ai ka bërë përpara njerëzve, me fakte, që nga koha që Allahu i Madhërueshëm ka krijuar Ademin (Paqja qoftë mbi të!) e deri në Kijamet. Nëse dikush është i kujdesshëm për nderin dhe fisnikërinë e tij, pa dyshim se duhet të jetë më i kujdesshëm dhe të mos bëjë punë të këqia, apo ndonjë gjynah, sepse Allahu i Madhëruar do t'ia ekspozojë atë Ditën e Kijametit.

Kur njeriu shkon për të dhënë llogarinë, i sillet libri i veprave të veta dhe i thuhet të shikojë librin e tij. Ai gjen në të çdo veprim që e ka bërë në jetën e vet. Nuk lihet asgjë pa u përmendur. Disa mund të pyesin për librat e atyre që kanë jetuar 100 apo 200 vite, për njerëzit e kohëve të mëparshme, të cilët jetonin më shumë se njëmijë vite.

Në ditët e sotme njerëzimi, me zhvillimin e teknologjisë, ka arritur që përmes një pajisjeje të vogël të posedojë informacion pa limit. A nuk është e mundur që edhe libri i punëve tona t'i ngjajë një ekrani ku të shfaqen skenat e jetës sonë?! Allahu di më së miri gjithçka!

Kur njeriu e lexon librin e tij duke qëndruar përpara Allahut të Madhëruar, humbet çdo shans për ta mohuar. Në gjykatat e dynjasë, për shembull, njeriu mund të gënjejë, të mashtrojë dhe të sjellë prova të fabrikuara që e ndryshojnë realitetin para syve të gjykatësit, por ai Ditën e Kijametit është shumë i dobët për ta bërë këtë, sepse çdo gjë është e regjistruar para tij në atë libër dhe pejgamberët, engjëjt dhe të gjithë banorët e tokës janë dëshmitarë kundër tij. Madje

edhe muret, shtëpitë ku kanë qenë vend i kryerjes së gjynaheve, dëshmojnë kundër tij. Kundër tij dëshmojnë edhe gjuha e tij, dora, dy këmbët e tij. A mundet të gënjejë ai, pra?

Cili do të jetë gjykatësi Atë Ditë? Ai është i Drejti i drejtësisë absolute, I Cili nuk bën padrejtësi as grimcën më të vogël dhe, siç lexojmë në Kur'an, nuk mund të ketë padrejtësi para Drejtësisë Absolute. Tek Ai nuk ka ndërmjetësime, tek Ai askush nuk frikësohet dhe askush nuk lakmon gjë, tek Ai, i Lartësuar qoftë, i Drejti, i Pasuri, i Forti, nuk fshihet asgjë. Dija e Tij i përfshin të gjithë situatat e robërve dhe gjendjet e tyre, sepse Ai i krijoi ata. Pra, kush do të mund të shpëtojë prej Tij?!

Në gjykatat e kësaj bote mund të jetë dikush që të të mbrojë, mund të punësosh ndonjë avokat që të të mbrojë,kurse atje nuk të mbron asgjë. Allahu i Madhëruar thotë: "... **secili njeri do të përpiqet për vetveten**"[65], prandaj nuk ekziston asnjë avokat i famshëm që të të mbrojë ty. Përkundrazi je ti vetë që do të mbrosh vetveten para gjithçkaje që ke bërë.

Rezultati i llogaridhënies do të jetë në dritën e drejtësisë hyjnore. Sipas saj mbahet qëndrimi definitiv: Kujt i rëndon peshorja, pra, e ka veprën të rëndë dhe e ka kaluar jetën e vet duke bërë vepra të mira dhe bamirësi, shkon në Xhennet, kurse ai që e ka peshoren e lehtë, ai që ka vepruar pak, ose ai që nuk ka vepra të mira, shkon në zjarr. Çështja

65 Sure "Nahl", ajeti 111.

nuk është aspak komplekse dhe nuk ka nevojë për ndonjë libër të drejtash të Botës Tjetër. I Madhërishmi thotë: "**Atij që i rëndon peshorja e veprave të tij, është në një jetë të këndshme. Ndërsa, ai që ka të lehtë peshoren e veprave të tij, do ta ketë vendin në Havije. Ku e di ti se ç'është** (Havije)? **Është zjarri me nxehtësinë shumë të lartë.**"[66] Pastaj shpërndahen dëshmitë dhe librat. Ai që e merr librin e tij nga e djathta, e ka vendin në Xhennet, kurse ai që e merr nga e majta e tij ose nga prapa, shkon në zjarr.

Kur shpallet vendimi, ose pak para shpalljes së vendimit, siç ndodh edhe në gjykatat e dynjasë, njeriu bën përpjekje të bëjë diçka që ta shpëtojë atë nga ajo fatkeqësi. Të gjitha këto kuptime janë prezente në Kur'an, por atje nuk bën dobi as apologjia, as pendimi e as keqardhja. Atje nuk bën asnjë dobi pranimi i gabimit, siç ndodh në gjykatat e dynjasë, në të cilat, po të pranosh gabimin. Mund të ketë ulje dënimi. Atje nuk bën dobi asgjë. Edhe sikur të paguash arin e gjithë botës, nuk do të të ulet dënimi që të jepet.

Allahu i Lartësuar thotë: "**Ditën kur nuk bën dobi as pasuria, as fëmijët**, (bën dobi) **vetëm kush i paraqitet Zotit me zemër të shëndoshë**"[67], pra nuk bën dobi as pasuria, as fëmijët. Përjashtim bën çështja e shehidëve dhe kjo është brenda temës së shefatit (ndërmjetësimit). "...**Atë Ditë nuk**

66 Sure "Karia", ajeti 6-11.
67 Sure "Shuara", ajetet 88-89.

bën dobi asgjë, as miku për mikun..."[68], prandaj atje nuk bën dobi asgjë, as pronari yt, as dijetari yt dhe as kolegu yt.

Thotë i Madhërishmi: "**Atë Ditë njeriu ikën prej vëllait të vet, prej nënës dhe prej babait të vet, prej gruas dhe prej fëmijëve të vet**"[69] pra, nuk i bën dobi as vëllai, as nëna, as babai, as gruaja dhe as fëmija.

Madje, nga tmerri i situatës atje "...**krimineli dëshiron të kishte paguar dënimin e Asaj Dite me bijtë e tij, me gruan e vet dhe vëllain e vet**", megjithëse në këtë botë ka qenë i gatshëm të skarifikojë veten e vet për të mbrojtur fëmijët e vet nga rreziqet dhe tmerret. "...**edhe me të afërmit e tij, te të cilët mbështetej...**" do me thënë, ishte gati të paguante edhe me shoqërinë, me të afërmit e tij, të partisë, të shtetit dhe të ushtrisë së tij, "**...edhe me krejt ç'ka ka në tokë, vetëm të kishte shpëtuar!**" Dhe atij i vjen përgjigjia: "**Jo, kurrsesi, ajo** (që ndodhet para) **është Ledhdha, është flaka,** (emër i Xhehennemit). **Është zjarri që të heq kapakun e kokës!**"[70] Ai është Xhehennemi që pret kriminelët dhe asgjë nuk të shpëton prej tij.

Pra, as pasuri, as fëmijë, as shpërblesë, as i afërt, as ndonjë i fisëm nuk bën dobi atje. Atje nuk i bën dobi lutja që bën: "**Zoti im, më kthe mua!**"[71] në dynja, por dynjaja ka mbaruar. Toka është bërë tjetër tokë dhe qielli tjetër qiell.

68 Sure "Duhan", ajeti 41.
69 Sure "Abese", ajetet 34-37
70 Sure "Mearixh", ajetet 11-16.
71 Sure "Mu'minun", ajeti 99.

ÇFARË BËN DOBI ATË DITË?

Garancia e Asaj Dite dhe dobia e vetme është besimi dhe vepra e mirë.

Për këtë ne shohim prijësin e besimtarëve Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!) të thotë: *"Allahu ju mëshiroftë, bëni sa më shumë vepra të mira, sepse është bërë thirrja për udhëtimin e gjatë dhe, me të vërtetë që vepra më e mirë që mund të bëni është devotshmëria"*[72].

Devotshmëria është rezultat i besimit dhe i veprës së mirë. Vepra e mirë bart një kuptim të gjerë. Ajo mbart adhurimin, xhihadin dhe moralin e mirë.

Vepra e mirë dhe urdhërimi në vepra të mira, dhënia e sadakasë nevojtarëve, ndihma e të dashurve, mbështetja e nevojtarëve, mbrojtja e dinjiteteve të njerëzve dhe ndereve të tyre, janë prej kritereve të veprave të mira, të cilave duke

72 Ajo që ka cituar shkëlqësia e tij është fjalë e marrë nga prijësi i besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!) e përmendur në Nehxhul Belaga, me tekstin: *"Përgatituni për rrugë, Allahu ju mëshiroftë, ngase tanimë jeni ftuar të shkoni. Konsiderojeni qëndrimin tuaj në këtë botë fare të shkurtër dhe kthehuni me pajisjen më të mirë të cilën e keni me vete, ngase vërtet, para jush ndodhen pengesa e cila vështirë tejkalohet dhe vendbanimet plot frikë e rreziqe. Gjer te ato duhet arritur dhe te ato duhet ndalur. Dijeni se shikimi i vdekjes drejt juve është shumë afër. Kjo është sikur të ndodheni në kthetrat e saj dhe sikur ajo të jetë qepur për ju. Punët e vështira dhe rreziqet tronditëse ju shtyjnë në të. Këputni pra të gjitha lidhjet me këtë botë dhe ndihmoni veten me pajisje të përkushtimit ndaj Zotit".*

u shtuar edhe besimin, përbëjnë të vetmen gjë që do të ketë dobi Ditën e Kijametit.

Duhet thënë se Allahu i Madhërueshëm ka lënë një portë të hapur për shpëtim. Ajo është dera e shefatit, e ndërmjetësimit, e ndërmjetësimi të pejgamberëve, të imamëve, të miqve të Allahut, të shehidëve. Megjithkëtë askush nuk e ka garancinë që atë do ta hapë ndërmjetësimi. Vetëm se ndërmjetësimi mbetet një nga dyert e shpresës. Ndëmjetësimi është përmendur në trasmetime dhe në ajete kur'anore dhe është vërtetuar dhe konfirmuar për shehidat, sepse ata ndërmjetësojnë për falje për familjen dhe të afërmit e tyre. Është i konfirmuar për pejgamberët dhe imamët e pagabueshëm si dhe për disa miq, eulija të Allahut vepërmirë si dhe grupime të tjera veç tyre, që Allahu është i kënaqur me ta, të cilët i përmendin trasmetimet[73] dhe këta ndërmjetësojnë me pozitën e tyre,

73 Shefaati Ditën e Llogarisë i atribuohet sipas disa trasmetimeve disa grupeve:

a) **Pejgamberit më të nderuar** (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshim mbi të dhe mbi familjen e tij!), trasmetohet prej tij se ai ka thënë: *"Mua më janë dhënë pesë gjëra që askujt nuk i është dhënë para meje; toka më është bërë mua xhami dhe pastrues, më janë lejuar plaçka e luftës, jam ndihmuar me tmerr, më është dhënë saktësia e fjalës dhe më është dhënë shefaati, ndërmjetësimi"*. Gjithashtu, trasmetohet prej tij se ka thënë: *"Unë kam një avantazh ndaj pejgamberëve të tjerë, pasi nuk ka pejgamber që nuk e ka bërë duanë për popullin e tij, kurse unë e kam vonuar atë, lutjen për ymetin tim që të bëj ndërmjetësim për ta ditën e Kijametit"*. Gjithashtu, prej tij thuhet: *"Kur unë të qëndroj tek vendi i falënderimit, kërkoj të bëj ndërmjetësim për ata që kanë bërë gjynahe të mëdha prej ymetit tim dhe Allahu më lejon të bëj ndërmjetësim për ta"*. E shumë thënie të tjera që vërtetojnë

ndërmjetësimin e tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshim mbi të dhe mbi familjen e tij!).

b) **Imamët e pagabueshëm dhe të gjithë pejgamberët** (Paqja qoftë mbi ta!), pasi citohet nga Imam Sadik (Paqja qoftë mbi të!) se ai ka thënë: "Ditën e Kijametit, askush nga pejgamberët dhe të Dërguarit e Allahut nuk bën ndërmejtësim deri kur t'i japë leje Allahu, përveç të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshim mbi të dhe mbi familjen e tij!), pasi me të vërtetë, Allahu i Madhëruar ia ka lejuar atij ndërmjetësimin që para Ditës së Kijametit, kështu, pra ndërmjetësimi është i tij dhe imamëve nga prejardhja e tij, pastaj pas kësaj është për pejgamberët e tjerë (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ta!)", përmendet nga Imam Bakiri dhe Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi ta!) se ata të dy kanë thënë: "*Për Zotin, ne do të ndërmjetësojmë për ndjekësit tanë gjynahqarë.*" etj.

c) **Grupe të veçanta të besimtarëve** (prej tyre janë dijetarët dhe shehidët), pasi citohet nga Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshim mbi të dhe mbi familjen e tij!) se ai ka thënë: "*Ai që e ndihmon dhe suporton nxënësin e dijes, atëherë ai i do pejgamberët dhe do jetë bashkë me ta dhe kush e urren nxënësin e dijes atëherë ai ka urryer pejgamberët dhe dënimi i tij është Xhehennemi, e me të vërtetë se nxënësi i dijes është ndërmjetësim njësoj si ndërmjetësimi i pejgamberëve.*" dhe nga Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "*Mos ji indiferent ndaj fukarenjeve të sektit tonë, se vërtetë fukarai i tyre do të ndërmjetësojë Ditën e Kijametit si pranvera e freskët.*" Nga Ajashi, nga Ubejdi bin Zurare se ai: ka pyetur Imam Sadikun (Paqja qoftë mbi të!) për besimtarin, a bën ai ndërmjetësim? ka thënë: "Po". Trasmetohet nga Imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) se ai ka thënë: "*Me të vërtetë i Dërguari i Allahut bën ndërmjetësim për ymetin e tij, kurse ne kemi ndërmjetësim për sektin tonë, kurse sekti jonë bën ndërmjetësim për familjarët e tyre*".

d) **Kur'ani Fisnik,** nga Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) thuhet se ka thënë: "*Kush e lexon Kur'anin kur është i ri dhe besimtar, Kur'ani përzihet me mishin dhe gjakun e tij dhe Allahu i Madhëruar e bashkon atë me udhëtarët fisnikë. Kur'ani do të jetë mbrojtës për të Ditën e Kijametit.*", e shumë të tjera si kjo.

me gradën dhe prestigjin e tyre tek Allahu i Lartësuar dhe afrimit që kanë me Të, e Ai është Bujar, Bamirës. Është Ai që e pranon ndërmjetësimin e tyre dhe kështu ata shpëtojnë nga zjarri njerëz që duhet të ishin tubuar brenda tij, (Xhehennemit).

Sigurisht ajo çështje ndodh brenda rregullit të Botës Tjetër ku ekzistojnë rregullat dhe përcaktimet e saj të përgjithshme, madje edhe për pejgamberët dhe shehidët. Ndërmjetësimi bëhet për njerëz të caktuar, të cilët e dinë se Allahu është i kënaqur që të ndërmjetësohet për ta, sepse jo të gjithë njerëzit e përfitojnë ndërmjetësimin.

Allahu i Madhëruar ka lënë hapur edhe një derë tjetër për shpëtim. Ajo është dera e mëshirës së Allahut të Lartësuar. Allahu i Madhëruar është i Gjithmëshirshëm dhe shumë i Dashur. Mëshira e Tij e ka kapërcyer inatin e Tij dhe Ai mund t'i falë ata njerëz që janë futur në zjarrin e Xhehennemit, të cilët kanë qenë kokëfortë në kundërshtimin e tyre, që bënë mendjemadhësi ndaj Tij, që i vunë ortak dhe e mohuan ekzistencën e Tij! Kjo falje e Allahut të Madhëruar bëhet sepse Ai e shpërndan mëshirën e Tij të madhe pikërisht Atë Ditë. Përhapja e saj bëhet aq shpejt, sa mendjet njerëzore nuk e perceptojnë dot! Edhe kjo çështje është në dorën dhe në dëshirën e Tij.

Trasmetimet e cituara më lart dhe të tjera veç tyre që sillen rrotull çështjes së ndërmjetësimit, që të gjitha përmenden në librin "Mealimu zulfa", fjalia e katërt, kapitujt 23 deri 28.

Në disa trasmetime thuhet se Allahu i Lartësuar, Ditën e Kijametit do të shpërndajë një mëshirë aq të madhe sa edhe shejtani do të zgjasë qafën e tij, me shpresën se do ta përfshijë edhe atë kjo mëshirë e madhe. Por Iblisi nuk ka asnjë vend tjetër, përveç Xhehennemit.

Mirëpo dyert e ndërmjetësimit dhe të mëshirës së shpërndarë nuk i përfshijnë të gjithë. Besimi dhe vepra e mirë janë garantuesit e vetëm. Çdo të mirë që të bëjmë do ta gjejmë atje. Vepra jonë e mirë na paraprin ne atje. Çdo e mirë e jona që bëjmë në këtë botë na paraprin ne atje. Kjo është garancia jonë e vërtetë!

NJË PËRMBLEDHJE E SHKURTËR PËR URËN E SIRATIT DHE PËRFUNDIMI

Pas këtyre fazave përfundon çështja. Banorët e Xhennetit shkojnë në Xhennet, tubohen brenda tij, njësoj si dhëndërri që martohet me nusen, kurse banorët e Zjarrit shkojnë në zjarr, tubohen dhe grumbullohen atje duke i marrë prej duarsh dhe këmbësh. Të gjitha këto detaje janë treguar në Kur'anin Fisnik dhe hadithet profetike dhe ato burime duhet të shikohen dhe lexohen me kujdes. (si sureja Zumer, për shembull).

Këtu flitet për Urën e Siratit, nëpër të cilën duhet të kalosh për të hyrë në Xhennet. Por, përtej metaforës, a është ajo një urë konkrete, materiale, përmes së cilës njerëzit ecin mbi Xhehennem për të arritur në Xhennet, apo kuptimi i saj është feja, ura hyjnore, do me thënë rruga e drejtë, të cilën, nëse e zgjedhim dhe e ndjekim, arrijmë në Xhennet?

Por fjala "*Sirat*" a është përdorur në kuptimin e vërtetë apo metaforik? Për këtë dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme. Disa prej tyre kanë pranuar mendimin e parë, kurse një pjesë tjetër kanë supozuar mendimin e dytë. Ky debat, (panvarësisht ngurrimit tonë), konsiderohet i rëndësishëm dhe meriton të rishihet tema e Siratit, ku të bëhet më shumë kujdes për detajet, problemet dhe shqetësimet që lidhen me fatin e njeriut.

Kushdo nga njerëzit që ka hyrë në Xhennet ka fituar. Përjetësia në të është rrugëtimi i tij. Kurse banorët e Xhehennemit ndahen në banorë që do të rrinë të përherë në zjarr dhe në banorë që do të dalin prej tij më pas, për shkak se janë përzier veprat e mira me veprat e këqia të tyre, ose sepse i përfshin mëshira e Alahut, apo prej ndërmjetësimit të ndonjërit prej atyre që bën ndërmjetësim. Pas këtyre ndodhive shpallet vendimi i faljes për ta dhe transferohen nga zjarri në Xhennet. Këtu nuk do të diskutojmë rreth detajit se ç'thuhet për ta. Më e mira do të ishte që të lexohet dhe të studiohet për këtë. Ajo që na intereson këtu është që dikush prej nesh të thotë se vërtet nëse vepra ime e mirë përzihet me veprën e keqe, atëherë do të hyj në zjarr për një periudhë kohe e pastaj do të nxirrem prej zjarrit, sepse askush nuk mund ta durojë asnjë sekondë frymënxjerrjen, ngashërimin, zjarrin që kundron në zemra.

Kështu përfundon skena e Kijametit.

NJË FJALË PËR FUNDIN E PARASHIKUAR TË STUDIMIT

Përshkrimi, tregimi dhe analiza që prezantuam ka për qëllim t'u tërheq vëmendjen njerëzve të hutuar e të pakujdesshmëm se në këtë jetë kanë përgjegjësi mbi supe. Detyra e çdo njeriu është që t'i përcaktojë vetes qëllimin që gjithmonë të kryejë vepra të mira, konform mësimeve kur'anore, sepse kur të vihemi përpara llogaridhënies, të mos kërkojmë ndihmë për shpëtim. I binduri ndaj Zotit do të shijojë mirësitë e Allahut të Madhërishëm, kurse mëkatari do të vajtojë e pikëllohet para dënimit të tmerrshëm!

Qëllimi që duhet t'i vemë vetes është të arrijmë gradën e adhurimit ndaj Allahut të Madhëruar, të ndarë nga bota e fjalëve, nga adhurimi për tempujt, për tregtarët, për skllavin, për njerëzit e lirë. Të adhurojmë Allahun e Madhëruar, të luftojmë për të arritur gradët e larta në këtë adhurim. Kjo është kaq e thjeshtë, prandaj nuk duhet t'ua vështirësojmë njerëzve thelbin e adhurimit të Allahut. Detyra jonë është të përpiqemi për të realizuar kuptimin e adhurimit të Allahut të Madhëruar në mesin tonë, duke zbatuar urdhëresat e Tij dhe duke respektuar ato që ndalon Ai.

I Lartësuari thotë: "...**e kush i shmanget zjarrit e futet në Xhennet, ai ka arritur shpëtim**"[74]Kjo është vërtet një arritje, një qëllim i merituar, për të cilin njeriu duhet të punojë gjatë gjithë jetës së tij për ta arritur. Prandaj, qëllimi im duhet të jetë që t'i shmangem zjarrit dhe të hyj në Xhennet, që Ditën e Kijametit të jem i sigurtë, i garantuar, kurse në Ditën e Tmerrit të Madh të jem i qetësuar dhe të më përfshijë mëshira e Allahut të Lartësuar dhe të mos skandalizohem përpara Allahut, engjëjve të Tij, pejgamberëve dhe gjithë njerëzve. Unë dëshiroj nderin dhe fisnikërinë, sigurinë dhe lumturinë, paqen dhe faljen në Botën Tjetër dhe të shpëtoj nga dënimi, të cilin nuk mund ta durojë asnjë shpirt. Synimi dhe detyra jonë është që të arrijmë atë që Allahu i Madhëruar ka kërkuar prej nesh: "... **ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët**"[75].

Por ky synim duhet të realizohet. Për realizimin e tij duhet të zbatojmë një plan dhe një program praktik, të cilin po e paraqesim të përmbledhur në disa hapa:

Së pari: Duhet të përmendim shpesh Ahiretin. Të mos harrojmë dhe të mos tregohemi të pavëmendshëm ndaj tij. Përmendja e Ahiretit, e varrit, e Barzakhut, e ngjarjeve të Kijametit dhe e përfundimit të tij, e Xhennetit dhe e Xhehennemit në mënyrë të kufizuar, vetëm me raste, si në Natën e Kadrit apo kur vdes ndonjë i afërm. Përkundrazi

74 Sure "Ali Imran", ajeti 185.
75 Sure "Tahrim", ajeti 6.

përmendja e tyre duhet të bëhet gjatë gjithë kohës, sepse vdekja vjen papritur dhe ne nuk kemi dituri se kur bëhet Kijameti. Prandaj, përmendja e vazhdueshme e vdekjes dhe e Ahiretit, janë hapat e parë të këtij procesi. Kjo vë jetën në lëvizje brenda nesh dhe na bën të ndjejmë vlerën e çasteve, orëve dhe ditëve që mund të kalojnë dhe pas kësaj të mos na ndajë nga Ahireti.

Së dyti: Të kemi kujdes Ahiretin. Këtë kuptim ka ajeti që flet për Ahiretin. Ai na fton që të kemi frikë Ahiretin, por ta përmendim atë sa më shpesh. Kështu ne i kushtojmë vëmendje atij dhe vështirësive të tij.

Së treti: Të bëjmë vepra për Ahiretin. Çdo njeri duhet të ketë një synim në jetën e tij të Dynjasë. Çdo njeri duhet të përpiqet që ta realizojë atë duke planifikuar me detaje dhe duke punuar ditë e natë. A nuk e meriton jeta e Ahiretit që njeriu të punojë maksimalisht për ta ndrequr dhe përmirësuar atë?! Së pari, njeriu duhet t'i kërkojë falje Allahut që t'ia falë gjynahet. Njeriu duhet të pendohet sinqerisht për mëkatet e mëparshme. Së dyti, të vazhdojë të falë namazet që ka humbur dhe obligime të tjera dhe nga pasuria e tij t'i japë hakun të vobegtit, si dhe të ruajë veten që të mos jetë i pavëmendshëm e të bjerë në gjynahe.

Shumë i rëndësishëm është orientimi i rinisë ndaj këtyre çështjeve.

Prandaj, është detyra e të gjithëve që të bëjmë vepra të mira, sa kohë jemi në këtë botë dhe gëzojmë shëndet të mirë që të fitojmë rrugën e Ahiretit, i cili nuk zgjat 50 apo 100 vjet

por miliona e milona vite e edhe më shumë. Ajo është shtëpia e përjetësisë.

Pa dyshim se detaji më i rëndësishëm në këtë program praktik është ndërprerja e lidhjes me dynjanë, me pasurinë, me luksin dhe me pasionet, sepse lidhja me to mund të të nxisë në veprime haram. Ka shumë të pabindur që kanë ndjekur një pasion apo një kënaqësi të kësaj bote, të cilat e kanë shtyrë në vepra të këqija dhe në gjynahe. Ne nuk flasim këtu për ndërprerje të të gjitha lidhjeve të njeriut me dynjanë, sepse dynjaja është ura e Ahiretit dhe secili prej nesh ka bashkëshort/e, fëmijë dhe interesa, të mira. Ajo që kërkohet është që kjo lidhje kërkohet të jetë pa kushte dhe e sinqertë. Lidhja me Ahiretin të jetë përmes zemrës dhe të jetojë në këtë botë si njerëzit punëmirë.

Këtë mesazh përcjell edhe përmbledhja e rrugës së Imam Hyseinit (Paqja qoftë mbi të!) dhe të githë atyre që ishin me të në Kerbela.

HISTORIA E KERBELASË NË PESHOREN E PËRPJEKJES PËR AHIRET

Në këtë kontekst, themi se një pjesë e njerëzve mund të kënaqen vetëm me përpjekjen që kanë bërë për shpëtimin nga zjarri dhe fitimin e Xhennetit, kurse një pjesë tjetër mund të ngrihen në grada dhe kënaqen me përpjekjen e tij që bëhet edhe shkak i shpëtimit të tjerëve. Por shkalla më e lartë e arritjes së kënaqësisë është përpjekja e njeriut për të arritur shpëtimin e të gjithë banorëve të tokës. Kjo ka qenë detyrë e pejgamberëve dhe imamëve dhe po kështu ka qenë edhe situata e Imam Hyseinit (Paqja qoftë mbi të!).

Hyseini (Paqja qoftë mbi të!) në Kerbala, me revolucionin dhe dëshminë e tij, ka dashur që t'i largojë njerëzit nga rruga e zjarrit dhe t'u sigurojë atyre një portë të hapur drejt Xhennetit, deri në Kijamet.

Po cila është esenca e ngjajrjes së Kerbelasë? Kjo ngjarje nuk na çon te një shoqëri që injoron të vërtetën dhe të kotën. Përkundrazi, e vërteta dhe e kota ishin të sqaruara plotësisht. Të gjithë muslimanët e asaj kohe e dinin se cili është Hyseini dhe cili është Jezidi. Hyseini (Paqja qoftë mbi të!) është pasardhës i të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe ai ka një pozitë të lartë dhe një vlerë të madhe në ymet dhe askush nuk mund të pretendojë të kundërtën. Pra, e vërteta është e qartë dhe e kota është e qartë. Beteja është e qartë

dhe qëllimet janë të qarta. Mirëpo problemi qëndron te një pjesë e njerëzve, të cilët janë kujdesur shumë për dynjanë e tyre. Ata janë lidhur pas saj, janë frikësuar për pasuritë dhe fëmijët e tyre, për shtëpitë dhe pjesën tjetër të Dynjasë së shkatërruar. Për këto arsye ata e lanë në baltë nipin e të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), madje ata e vranë brutalisht. Një pjesë e tyre, për hir të postit në Rraj, në Kufe apo Basra, e lanë në baltë Hyseinin dhe e vranë atë. Për këtë arsye ata e humbën Ahiretin. Madje Allahu i Madhëruar i turpëroi dhe i përjashtoi ata nga arritja e mirësive të dynjasë.

Përballë tyre gjejmë një pjesë të njerëzve, të cilët ishin pakicë, por e njohën Allahun dhe iu frikësuan çastit të qëndrimit dhe llogarisë para Tij. Ata ishin: Habib bin Medhahiri, shejkhu i madh i bindur, Zuhejr bin Kajni, Abas bin Ali dhe Kasimi, djali, si dhe burra dhe gra të tjerë që ishin në Kerbela. Këta kanë një shtëpi në llogarinë e tyre që vjen më poshtë:

Kur të tubohemi në shkretëtirën e Mahsherit, të qëndrojmë para Allahut të Madhëruar dhe të pyetemi për lëshimin e Hyseinit, të birin e bijës së të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), i cili ishte mbrojtës i fesë sonë dhe urdhëronte për vepra të mira, urdhëronte ndalimin e sjelljeve të gabuara, urdhëronte për të kryer detyrën dhe të pyetemi nëse e kishim për detyrë që ta mbështesnim atë, si do të themi? Pa dyshim se përgjigjia jonë do jetë: “Po, o Zot, ne qëndruam

bashkë me të, ndenjëm me të, e mbështetëm atë, jemi tharë për ujë së bashku, kemi luftuar së bashku, jemi vrarë dhe copëtuar përpara tij që të tubohemi Ditën e Kijametit me fytyra të bardha, Ditën kur disa fytyra do të zbardhen shumë e disa të tjera do të nxihen."

Kjo është historia e Kerbelasë dhe e vërteta rret saj.

Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin për ty, o i nderuari im, i dashuri im, o babai i Abdullait, Hysein, o biri i të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Paqja qoftë edhe mbi ata shpirtëra që kanë rrethuar oborrin tënd! Të gjithë ju keni selam nga ana ime, paqja e Allahut qoftë mbi ju, sa të jetë dita dhe nata!

Paqja qoftë mbi Hyseinin, mbi Aliun, babain e Hyseinit, mbi fëmijët e Hyseinit si dhe mbi shokët e Hyseinit!

Falënderimi i qoftë Allahut, Zotit të botëve.

INDEKSI I AJETEVE KUR'ANORE

Sure "Bekare", ajeti 48

"**Dhe ruajuni Një Dite, kur askush askujt nuk do të mund të kryejë asgjë, kur nuk pranohet për të,** (jobesimtarin), **ndonjë ndërmjetësim dhe kompensim për të, e as që do të ndihmohen ata** (fajtorët)".

Sure "Bekare", ajeti 126

Dhe kur Ibrahimi tha: "Zoti im, bëje këtë një qytet sigurie dhe banorët e tij, që besuan Allahun dhe Jetën Tjetër, furnizoi me lloje të frutave!"

Sure "Bekare", ajeti 154

" E për ata që u mbytën në rrugën e Allahut mos thoni: 'Janë të vdekur."

Sure "Bekare", ajeti 154

"**Jo, ata janë të gjallë, por ju nuk kuptoni** (gjallërinë e tyre)."

Sure "Bekare", ajeti 258

"**A nuk ke arritur të dish për atë, të cilit, ngaqë Allahu i kishte dhënë pushtet, ai,** (Nemrudi), **polimezoi me Ibrahimin rreth Zotit të tij. Kur Ibrahimi tha: 'Zoti im është Ai që jep jetë dhe vdekje!' Ai tha: 'Edhe unë jap jetë**

dhe vdekje!' Ibrahimi tha: "Zoti im e sjell Diellin nga lindja, sille, pra, ti atë nga perëndimi." Atëherë ai që nuk besoi mbeti i hutuar. Allahu nuk e shpie në rrugë të drejtë popullin mizor!"

Sure "Ali Imran", ajeti 169-170

"**Përkundrazi, ata janë të gjallë duke u ushqyer te Zoti i tyre, janë të gëzuar me atë që u dha Allahu nga të mirat e Tij.**"

Sure "Ali –Imran", ajeti 169

"**Kurrsesi të mos mendoni se janë të vdekur ata që ranë dëshmorë në rrugën e Allahut. Përkundrazi, ata janë të gjallë duke u ushqyer te Zoti i tyre**".

Sure "Ali-Imran", ajeti 170.

"... **dhe ata që kanë mbetur ende pa iu bashkuar rradhëve të tyre, i përgëzojnë.**"

Sure "Ali-Imran", ajeti 170-171

"... **se për ta nuk ka as frikë dhe nuk kanë pse të brengosen. Ata janë të gëzuar me begati e dhurata që ua dha Allahu, e s'ka dyshim se Allahu nuk ua humb shpërblimin besimtarëve.**"

Sure "Ali-Imran", ajeti 185

"... **e kush i shmanget zjarrit e futet në Xhennet, ai ka arritur shpëtimin**".

Sure "Nisa", ajeti 87

"**Allahu është Ai që nuk ka tjetër Zot përveç Tij, Ai patjetër do t'ju tubojë Ditën e Gjykimit, për të cilën nuk ka dyshim. E kush mund të jetë më i vërtetë se Allahu në thënie**?"

Sure "En'am", ajeti 31

"**Ata që përgënjeshtruan se do të takohen me Allahun** (Ditën e Gjykimit) **kanë humbur. Derisa t'u vijë Momenti**, (Kijameti), **befas, atëherë do të thonë: 'Të mjerët ne për atë që lëshuam'** (nga punët e mira në Dynja) **dhe ata do t'i bartin gabimet e veta në shpinë. Sa e shëmtuar është ajo që bartin**!"

Sure "A'raf", ajeti 59

"**Ne e patëm dërguar Nuhun te populli i vet, e ai tha: "O populli im, adhurojeni Allahun! Ju nuk keni tjetër Zot, përveç Tij. Unë kam frikë për dënimin tuaj në një Ditë të Madhe!**"

Sure "A'raf", ajeti 156

"**Dhe cakto për ne** (jetë) **të mirë në Dynja dhe të mirë në Botën Tjetër, pse vërtet jemi kthyer nga Ti !**"

Sure "A'raf", ajeti 187

"**Të pyesin ty,** (o Muhamed), **për Çastin,** (Katastrofën e përgjithshme) **se kur do të ndodhë ai. Thuaj: 'Atë e di**

vetëm Zoti im, kohën e tij nuk mund ta zbulojë kush, përveç Tij. (Ai e sjell Kijametin pa e hetuar asnjë nga krijesat). **Çështja e tij,** (se kur do të ndodhë), **është preokupim i rëndë** (për krijesat) **në qiej e në tokë. Ai,** (Kijameti), **nuk ju vjen ndryshe, vetëm befas. Të pyesin ty sikur ti di për të. Thuaj: 'Për të di vetëm Allahu, por shumica e njerëzve nuk e dinë,** (sepse është e fshehtë)".

Sure "Jusuf" ajeti 101

Pasi iu plotësua dëshira, Jusufi tha: " **Zoti im! Ti më ke dhënë mua pushtet, ma mësove mua komentimin e ëndrrave! O Krijues i qiejve e i tokës! Ti je kujdestari im në Dynja e në Ahiret! Ti bëj të vdes musliman dhe më bashko me të mirët!**"

Sure "Ibrahim", ajeti 48

"**Ditën kur toka ndryshohet në tjetër tokë dhe qiejt** (në të tjerë qiej, **e ata,** (njerëzit**), të gjithë dalin sheshazi para Allahut, Një, Mbizotërues.**"

Sure "Nahl", ajeti 111

"**Secili njeri do të përpiqet për vetveten.**"

Sure "Isra", ajeti 72

"**E kush ka qenë i verbër në Këtë** (Botë), **ai edhe në Botën Tjetër do të jetë i verbër dhe më i humburi i rrugës së drejtë.**"

Sure "Merjem", ajeti 85

"**Ditën kur do t'i tubojmë të devotshmit te i Gjithëmëshirshmi si mysafirë të ftuar.**"

Sure "Merjem", ajeti 95

"**Dhe në Ditën e Kijametit secili do t'i paraqitet Atij i vetmuar.**"

Sure "Ta-ha", ajeti 15

"**S'ka dyshim se Momenti,** (Kijameti), **do të vijë patjetër, Unë e kam fshehur atë plotësisht.** (Do të vijë) **për t'u shpërblyer secili njeri për atë që ka bërë.**"

Sure "Haxhxh", ajeti 1-2

"**O ju njerëz, ruajuni dënimit nga Zoti juaj, sepse dridhja pranë katastrofës së Kijametit është një llahtari e madhe. Atë Ditë, kur ta përjetoni atë, secila gjidhënëse braktis atë që ka për gjiri dhe secila shtatzënë e hedh para kohe barrën e vet, ndërsa njerëzit duken të dehur, po ata nuk janë të dehur, por dënimi i Allahut është i ashpër!**"

Sure "Mu'minun", ajetet 99-101

"**E kur ndonjërit prej tyre i vejn vdekja, ai thotë: "O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira e ta kompensoj atë që lëshova!" Kurrsesi,** (kthim nuk ka**) e kjo është vetëm një fjalë që e thotë ai, e ata kanë para tyre një perde,** (distancë periodike), **deri në ditën kur ringjallen. E kur i fryhet Surit,** (herën e dytë), **atëherë, Atë Ditë nuk do të**

ketë lidhje familjare mes atyre e as që do të pyesë kush për njëri-tjetrin."

Sure "Shuara", ajetet 88-89

"**Ditën kur nuk bën dobi as pasuria, as fëmijët**, (bën dobi) **vetëm kush i paraqitet Zotit me zemër të shëndoshë.**"

Sure "Kasas", ajeti 83

"**Atë vend të përjetshëm,** (Xhennetin), **ua kemi përcaktuar atyre që nuk duan as mendjemadhësi e as ngatërresë në tokë, e përfundimi i këndshëm u takon atyre që i frikësohen Allahut**".

Sure "Kasas", ajeti 4

"**Me të vërtetë, Faraoni ka ngritur kokën lart në tokë, e popullin e saj e ka grupëzuar dhe një grup prej tyre e shtyp, djemtë e tyre ua mbyt, e gratë e tyre ua lë të jetojnë. Vërtet, ai ishte prej më shkatërrimtarëve!**"

Sure "Kasas", ajeti 77

"... **e mos lë mangut atë që të takon në Këtë Botë**".

Sure "Ah'zab", ajeti 10

"... **e zemrat arritën në fyt...**"

Sure " Jasin" ajeti 49

Allahu u përgjigjet:" **Nuk janë duke pritur tjetër, vetëm se një britmë që i rrëmben ata kur janë duke u zënë mes tyre.**"

Sure " Jasin", ajeti 51

"**Dhe i fryhet Surit, kur ja, duke u ngutur prej varrezave paraqiten para Zotit të tyre.**"

Sure " Jasin", ajeti 52

"**E thonë: 'Të mjerët ne! Po kush na ngriti prej ku ishim të shtrirë në varre?' E, kjo është ajo që premtoi Zoti dhe vërtetuan pejgamberët.**"

Sure " Jasin", ajeti 53

"**Ajo nuk është tjetër, përveç një zë i fuqishëm dhe ata të gjithë do të paraqiten para Nesh.**"

Sure "Zumer", ajeti 9

" (A jobesimtari e ka gjendjen më të mirë), a**po ai që kohën e natës e kalon në adhurim duke bërë sexhde, duke qëndruar në këmbë, i ruhet** (dënimit të) **Botës Tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të vet? Thuaj: ' A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?' Vërtet, vetëm të mençurit marrin mësim.**"

Sure "Zumer", ajeti 30

"**Ti do të jesh i vdekur, edhe ata do të jenë të vdekur**".

Sure "Zumer", ajeti 68

"**Dhe i fryhet Surit dhe bie i vdekur çka ka në qiej dhe çka ka në tokë, përveç atyre që do Allahu** (të mos vdesin), **pastaj i fryhet atij herën tjetër, kur ja, të gjithë ata të ngritur e presin** (urdhërin e Zotit)."

Sure "Zumer", ajeti 69

"**Toka është ndriçuar me dritën e Zotit të vet.**"

Sure "Gafir", ajeti 18

"... **kur zemrat, të mllefosura arrijnë në fyt...** "

Sure "Gafir", ajeti 45

"**Dhe Allahu e shpëtoi atë** (besimtarin) **prej të këqijave që i kurdisën, ndërsa idhujtarët e Faraonit i përfshiu dënimi i keq.**"

Sure "Gafir", ajeti 46

"... **e Ditën e Kijametit,** (u thuhet engjëjve): '**Ithtarët e Faraonit futni në dënimin më të rëndë.**"

Sure "Zuhruf", ajeti 66

"**Nuk presin tjetër ato** (grupe) **përveç Katastrofës, t'u vijë befas duke mos e hetuar fare.**"

Sure "Duhan", ajetet 30-31

"**Ndërsa Ne i shpëtuam Beni Israilët prej vuajtjeve nënçmuese, prej Faraonit. Vërtet, ai ishte mizor i pakufishëm.**"

Sure "Duhan", ajeti 41

"**Në Atë Ditë nuk bën dobi asgjë miku për mikun, e as nuk mund të ndihmohen.**"

Sure "Fet'h", ajeti 10

" ... **se Dora e Allahut është mbi duart e tyre.**"

Sure "Kaf", ajeti 44

"**Ditën kur me ata hapet toka e ata nguten** (për vendtubim) **e ai është një tubim i lehtë për Ne.**"

Sure "Kaf", ajeti 42

"**Ditën kur e dëgjojnë thirrjen për të vërtetën,** (ringjalljen), **e ajo është Dita e Daljes** (prej varrezave)."

Sure "Rrahman", ajetet 26-27

"**Çdo gjë që është në të** (në tokë) **është zhdukur. E do të mbetet vetëm Fytyra e Zotit tënd** (Zoti yt) **që është i Madhëruar e i Nderuar**!"

Sure "Vakia", ajetet 4-6

" (Ajo ndodh) **Kur toka tundet me dridhje të forta, e kodrat shkapërdredhen e bëhen copë e thërrime, e bëhen pluhur i shpërndarë.**"

Sure "Tahrim", ajeti 6

"... **ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët!**"

Sure "Hakka", ajeti 13

"**E kur të fryhet në Sur një fryrje...**"

Sure "Hakka", ajeti 14

"... **dhe kur të ngriten malet e kodrat e ta godasin vrullshëm njëra-tjetrën me një të goditur...**"

Sure "Hakka", ajetet 15-16

"**Në atë kohë ndodh Ndodhia e Madhe,** (Kijameti). **E qielli çahet, pse ai Atë Ditë është i brishtë.**"

Sure "Mearixh", ajetet 15-16

"**Jo, kurrsesi, ajo** (para) **është Ledhdha, flaka** (emër i Xhehennemit). **Është flaka që heq kapakët e kokës!**"

Sure "Mearixh", ajetet 11-12

"**Edhe pse ata shihen ndërmjet tyre** (edhe njihen, por ikin prej njëri-tjetrit). **Krimineli dëshiron sikur të kishte**

paguar dënimin e Asaj Dite me bijtë e vet. Dhe me gruan e vet dhe me vëllain e vet.

Sure "Mearixh", ajeti 13

"**Edhe me të afërmit e vet, te të cilët mbështetej**".

Sure "Mearixh", ajeti 14

"**Edhe me krejt ç'ka ka në tokë, e vetëm të kishte shpëtuar**".

Sure Muzemmil ajeti 14

"**Atë Ditë kur toka e kodrat të dridhen, e kodrat bëhen rërë rrëshqitëse...**"

Sure "Murselat", ajetet 7-10

"**S'ka dyshim se ajo që premtoheni ka për të ndodhë patjetër! Kur yjet të shuhen, dhe kur qielli të hapet dhe kur kodrat të copëtohen...**"

Sure "Naziat", ajeti 9

"**Shikimet e tyre janë të poshtëruara** (frikësuara)".

Sure "Naziat", ajetet 10-11

"**Ata,** (idhujtarët në Dynja), **thonë: "A thua do të bëhemi përsëri kështu si jemi? A edhe pasi të jemi bërë eshtra të kalbura**?"

Sure "Naziat", ajetet 15-25

"**A të ka ardhur ty rrëfimi i Musait? Kur Zoti i tij e pat thirrur në luginën e bekuar Tuva,** (rrëzë kodrës Turi Sina). **Shko te Faraoni se vërtet ai e ka tepruar. Dhe thuaj: 'E ke ndërmend të pastrohesh? Unë të udhëzoj te Zoti yt e ti t'ia kesh frikën Atij! Dhe ai ia tregoi mrekullinë e madhe. Po ai e përgënjeshtroi dhe e kundërshtoi. Pastaj u kthye prapa dhe iku me të shpejtë. I tuboi** (të gjithë të vetët) **dhe u mbajti fjalim. E u tha: 'Unë jam zoti juaj më i lartë!' Atëherë Allahu tmerrshëm e dënoi atë për këtë të fundit dhe për atë të parën!**"

Sure "Abese", ajetet 34-36

"**Atë Dnjeriu ikën prej vëllait të vet, prej nënës dhe babait të vet, prej gruas dhe dhe prej fëmijëve të vet!**"

Sure "Abese", ajeti 37

"**Atë Ditë secilit njeri i mjafton çështja e vet.**"

Sure "Tekvir", ajeti 1

"**Kur Dielli të jetë mbështjellur** (dhe errësohet)..."

Sure "Tekvir", ajetet 2-6

"... **dhe kur yjet të kenë udhëtuar** (e bërë pluhur në ajër), **dhe kur devetë e shtrenjta të lihen pa bari në fushë dhe kur egërsirat të jenë bashkuar** (tubuar), **dhe kur detet të vlojnë si zjarr i flakëruar...**"

Sure "Tekvir", ajetet 7-11

"... **dhe kur shpirtrat të jenë bashkuar, dhe kur të pyeten ato vajza të varrosura të gjalla, për çfarë mëkati janë mbytur, dhe kur fletushkat të jenë shpalluar dhe kur qielli të jetë hequr...** "

Sure "Tekvir", ajeti 12

"... **dhe kur Xhehennemi të jetë ndezur fort ...** "

Sure "Tekvir", ajeti 13

"**dhe kur Xhenneti të jetë afruar**"

Sure "Tekvir", ajeti 14

"... **atëbotë njeriu do ta dijë se çka ka ofruar,** (të mirë ose të keqe...)"

Sure "Infitar", ajetet 1-4

"**E kur qielli të çahet, dhe kur të shkapërdredhen yjet dhe kur të përzihen detet dhe kur të trazohen varret...** "

Sure Inshikak ajetet 1-4

"**Kur të pëlcet qielli, t'i bindet urdhërit të Zotit të vet, ashtu si takoi. Dhe kur toka të shtrihet në gjerësinë e saj, e të nxjerrë ç'ka ka brenda e të çlirohet ...** "

Sure "Zelzeleh", ajetet 1-6

"**Kur të dridhet toka me dridhjen e saj të fuqishme dhe të nxjerrë atë që ka në brendinë e saj,** (barrën nga brenda), **dhe njeriu të thotë: 'Ç'ka kjo** (që bën këtë dridhje)?' **Atë Ditë ajo i rrëfen tregimet e veta, ngase Zoti yt e ka urdhëruar atë. Atë Ditë njerëzit shfaqen të ndarë në grupe që të shpërblehen për veprat e tyre.**"

Sure "Karia", ajetet 1-5

"**Krisma** (e Kijametit**). Ç'është Krisma? Dhe ç'të mësoi ty se ç'është Krisma? Ajo është Dita kur njerëzit bëhen si insekte të shpërndara dhe kodrat bëhen si leshi i shprishur!**"

Sure "Karia", ajetet 6-11

"**E sa i përket atij që i rëndohet peshoja e veprave të tij, ai është në një jetë të këndshme. Ndërsa, atij që ka të lehtë peshoren e veprave të tij, vendi i tij do të jetë Havije. E ç'është ajo që të njoftoi se ç'është** (Havije)? **Është zjarri me nxehtësi shumë të lartë!**"

Sure "Mesed", ajetet 1-5

"**Qoftë i shkatërruar Ebi Lehebi, e ai është i shkatërruar! Atij nuk i bëri dobi pasuria e vet, as ajo ç'ka fitoi! Ai do të hyjë në një zjarr të ndezur flakë. Edhe gruaja e tij, ajo që barti dru, e në qafën e saj ajo ka një litar të përdredhur.**"

PËRMBAJTJA

Parathënie.....5
Hyrje.....7
Në kujtim të vdekjes dhe Botës Tjetër.....7
E vërteta e vdekjes dhe pyetjet ngulmuese.....9
Çfarë ka pas vdekjes?.....11
Po çfarë ndodh me këtë kufomë që u varros?.....12
Po me shpirtin çfarë ndodh?.....13
Nevojat e njohjes me Botën Tjetër.....14
Argumentet për ekzistencën e një jete pas vdekjes.....18
Pjesa e parë.....24
Varri dhe Barzakhu janë shtëpitë e para të Ahiretit.....24
Argumentimi për ekzistencën e Botës së Barzakhut.....27
Një analizë për Fazat e Botës së Barzakhut.....29
Ndarja e krijesave në Botën e Barzakhut.....35
Një ndalesë për gjendjen e shehidave në Barzakh.....41
Fjala për grupin e tretë.....43
Një këshillë për veten dhe për besimtarët.....45
Pjesa e dytë.....51
Fundi i udhëtimit.....51
Situatat e rënda të Kijametit të Madh dhe tmerret e tij.....51
Prezantim.....52
Përdorimi gjuhësor ndërmjet të vërtetës dhe metaforës.....52
E vërteta dhe metafora në Kur'anin Fisnik.....55

Treguesit e Kijametit të Madh dhe ngjarjet që ndodhin në të.....57
Situata e krijesave të gjalla në Ditën e Kijametit.....60
Si ua merr jetën Allahu atyre?.....61
Skena universale në Kijamet.....65
Edhe qielli çahet dhe copëtohet.....66
Një qëndrim shqyrtues për dëshmitë e tesktit kur'anor.....68
Ringjallja e të vdekurve.....73
Qëndrimi përpara Allahut për llogaridhënie.....78
Çfarë bën dobi Atë Ditë?.....84
Një përmbledhje e shkurtër për Urën e Siratit dhe përfundimi.....89
Një fjalë për fundin e parashikuar të studimit.....91
Historia e Kerbelasë në peshoren e përpjekjes për Ahiret...95
Indeksi i ajeteve kur'anore.....98

اسم الكتاب: **صحراء المحشر**

المؤلف: **السيد حسن نصرالله**

المترجم: **ولنت مريا**

التصحيح اللغوي و الأدبي: **اسعد بونغوري**

التدقيق: **صبريه فزا**

الاخراج النهائي و تصميم الغلاف: **صبريه فزا**

ناشر: **جمعية النسيم – تيرانا – ألبانيا**